




ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

Bankieri

Botim i Shoqatës Shqiptare të Bankave

Nr. 18, Janar 2016

ISSN 2225-2959



ANTI Të dy anët e monedhës
INFORMALITETI



ANËTARËT E AAB

 ALPHA BANK	 abi AMERICAN BANK OF INVESTMENTS	 BKT BANKA KOMBETARE TREGTARE	 CREDINS bank
 CBA CREDIT BANK OF ALBANIA BANKA E KREDITIT E SHQIPTARE	 Fibank First Investment Bank	 INTERNATIONAL COMMERCIAL BANK rëndësi kanë vlerat	 INTESA SANPAOLO BANK Albania
 NBG Bank	 ProCredit Bank	 Raiffeisen BANK	 SOCIETE GENERALE ALBANIA
 TIRANA BANK	 UNIONBANK	 UBA Banka e Bashkuar e Shqiptare United Bank of Albania	 VENETO BANKA GRUPPO VENETO BANCA

Përmbajtja



ANTI INFORMALITETI

Të dy anët e monedhës

Bankieri është publikimi zyrtar i Shoqatës Shqiptare të Bankave i cili i dedikohet kryesisht sektorit bankar shqiptar. **Bankieri** i jep lexuesit një informacion të vlefshëm mbi arritjet e industrisë në përgjithësi dhe të bankave tregtare në veçanti.

SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

Rr. Ibrahim Rugova,
SKY TOWER, 9/3, Tiranë
Tel: +355 4 2280371/2
Fax: +355 4 2280 359
E-mail: bankieri@aab-al.org;
www.aab.al

Bankieri

Nr.18, Janar 2016
Botim i Shoqatës Shqiptare të Bankave

Editorial

Anti - informaliteti
Nga fjala e ditës te rregulli i ditës!
Elvin MEKA

Tema e Ditës

Bankat përballë informalitetit
Si duhet të veprojnë?
Gideon Van Den BROEK
Formalizimi i Ekonomisë
Një përpjekje shumë komplekse
Arben MALAJ

Intervistë

Banka Amerikane e Investimeve (ABI)
Një sinergji e re midis bankës dhe jobankës
Andi BALLTA

Sistemi Bankar

Financimi i tregtisë:
A ka kërkesë për të në Shqipëri?
Ardita SEKNAJ
Fitimet e bankave... në shënjestër!
Ermal NAZIFI

Speciale

Edukimi financiar: Një investim thelbësor
Wim MIJS

Forumi i Ekspertëve

EUROBOND-i i qeverisë shqiptare:
Një rriemtim i suksesshëm
Suela TOTOKOÇI
Të dhënat masive (Big Data)
dhe sistemi bankar shqiptar
Alban BURAZERI
Sistemet e pagesave elektronike në Shqipëri
Projekte dhe risi për rritjen e efikasitetit
Irida HUTA, Dritan MOLLANJI

Këndi i Ekonomistit

Mesazhet dhe efektet e vendimit të FED për rritjen
e normës së interesit
Adrian CIVICI

Përgjegjshmëria Sociale

Aktivitetet nga Bankat

Teknologji

Qendrat e Operacioneve të Sigurisë
Sfidat dhe përparësitë që ofrojnë
Anila HOXHA

Auditori Financiar

Ristrukturimi i huas
Testimi i klientit përpara vendim-marrjes për restrukturim
Elsa PECA

AAB Aktivitete

AAB Trajnimet

REDAKSIA:

Elvin Meka
Kryeredaktor
Eftali Peçi
Koordinatorë Produksioni
Junida Tafaj (Katroshti)
Bashkëpunëtorë
Andis Rado
Fotograf
Design & Layout: FCB Afirma

Printed by:  Gentigrafik

BORDI EDITORIAL:

- 5
6
8
12
14
17
19
21
24
26
29
33
37
39
42
43
- Christian CANACARIS
Kryetar i Bordit Drejtues
të AAB-së & Drejtor i
Përgjithshëm i Raiffeisen
Bank Shqipëri
- Gazmend KADRIU
Nënkryetar i i Bordit
Drejtues të AAB-së &
Drejtor i Përgjithshëm i
Union Bank
- Periklis DROUGKAS
Anëtar i Bordit Drejtues
të AAB-së & Drejtor i
Përgjithshëm i Alpha Bank
Albania
- Seyhan PENCABLIGIL
Anëtar i Bordit Drejtues
të AAB-së & Drejtor i
Përgjithshëm i Banka
Kombëtare Tregtare
- Frédéric BLANC
Anëtar i Bordit Drejtues
të AAB-së & Drejtor i
Përgjithshëm i Societe
Generale Shqipëri
- Bozhidar TODOROV
Anëtar i Bordit Drejtues
të AAB-së & Drejtor i
Përgjithshëm i Fibank
Shqipëri
- Endrita XHAFERAJ
Sekretare e Përgjithshme,
Shoqata Shqiptare e
Bankave
- Hysen ÇELA
Kryetar i Institutit të
Ekspertëve Kontabël të
Autorizuar
- Adrian CIVICI
President i Universitetit
European të Tiranës
- Spiro BRUMBULLI
Drejtor i kabinetit të
Ministrit të Financave
- Enkeleda SHEHI
Drejtoresh Ekzekutive e
Autoritetit të Mbikqyrjes
Financiare

Programi i Shpërblimit Alpha Bank Bonus

Programi i ri i shpërblimit Alpha Bank Bonus është krijuar për të shpërblyer të gjithë kartëmbajtësit American Express nga Alpha Bank Albania. Duke përdorur kartën tuaj të debitit **Enter American Express** dhe kartat e kreditit **American Express Green** dhe **American Express Gold** në listën e tregtarëve partnerë në këtë program, ju përfitoni rimbursim në llogarinë e kartës suaj deri në 5% të vlerës për çdo blerje që ju kryeni.


Vizitoni një nga degët e Alpha Bank Albania për t'u njohur me kushtet e programit të shpërblimit Alpha Bank Bonus. Për më shumë informacion na telefononi në numrin 042 240 477 ose vizitoni www.alphabank.al.

Jepini vetes një BONUS!

BONUS

ALPHA BANK

Programi i ri i shpërblimit nga
Alpha Bank Albania dhe American Express®.



Përdorni kartat tuaja **American Express®** për blerje në tregtarë të përzgjedhur në Shqipëri dhe përfitoni **rimbursim deri në 5% të vlerës** për çdo blerje.

American Express është një markë e regjistruar e American Express®.
Alpha Bank Albania është lëshuese ekskluzive e kartave American Express® në Shqipëri.



ALPHA BANK

BONUS

ALPHA BANK

Jepini vetes një Bonus.

CARPISA

Carrefour

GEOX

GOLDEN LADY

goldenpoint



MANGO

NEPTUN

okaïdi

PARFOIS

Prenatal

SPRINGFIELD



nga Prof. Asoc. Dr. Elvin MEKA¹
Kryeredaktor

Gjatë tremujorit të fundit të vitit 2015, anti – informaliteti u kthye jo vetëm në fjalën e ditës, por dhe në aksionin e ditës, duke u vendosur në qendër të gjithë debateve dhe diskutimeve profesionale, sociale dhe politike. Sigurisht që, jo vetëm në rastin e Shqipërisë, por gjithkund, aksione dhe sipërmarrje të tilla vlerësohen, gjykohen dhe paragjykojnë, sipas grupeve të ndryshme të interesit. Pavarësisht nga kjo, shumëfishi më i vogël i përbashkët i gjithë kësaj sipërmarrje të guximshme qeveritare mbetet nevoja për një shkallë më të lartë formalizimi të ekonomisë kombëtare, ndërkohë që mbetet gjithnjë i hapur diskutimi mbi qasjen e ndjekur në zbatimin e një aksioni të tillë.

Mbetet një fakt i jetës që, bankat tregtare në Shqipëri, kanë qenë në krye dhe në mbështetje të çdo lloj përpjekjeje dhe sipërmarrjeje, me objekt veprimtarinë ekonomike formale dhe formalitetin ekonomik e financiar. Këtu duhet të theksohet fakti se, bankave në Shqipëri, që në ditën e parë të punës u është dashur të përballen me një pragmatizëm dhe paradoks ekstrem: rritje dhe zgjerim të portofolit

Anti - informaliteti

Nga fjala e ditës te rregulli i ditës!



Për gjithkënd duhet të jetë e qartë se, formalizimi i ekonomisë është një sistem i domosdoshëm reformash, jo pak të dhimbshme e komplekse, veçanërisht në kushtet e ekonomisë dhe shoqërisë shqiptare, por ai nuk mund të reduktohet dhe identifikohet thjesht me një aksion taksidarësh, që prodhon më shumë të ardhura fiskale dhe xhiro të faturuar.



të huas dhe ruajtje të standardeve të huadhënies, duke filluar nga zero, drejt një sipërmarrjeje dhe ekonomie fillestare kapitaliste, pa asnjë lloj kulture të trashëguar biznesi, financiare dhe fiskale, në kushtet e një formati të ri qeverisjeje, për të cilën kjo e fundit duhej të paguante tashmë detyrime tatimore. Në këtë mozaik zhvillimi ekonomik, politik e social të 25 viteve të fundit, është punuar fort nga të gjithë, që informaliteti të mos jetë më shumë rregull sesa përjashtim, ku bankat kanë qenë padyshim faktori dhe mekanizmi kyç në një tranzicion të tillë, përmes “pushtetit të butë” të rregullsisë së dokumenteve dhe përbushjes sa më të mirë të standardeve të huadhënies. Patjetër që këtu jo të gjitha betejat janë fituar, si nga qeveria, ashtu dhe nga bankat, por e sigurt është se “lufta” është e gjatë, për të mos thënë e vazhdueshme e pa afat, pasi parimi i saj është thjesht i drejtë dhe sfida tashmë duhet të jetë kalimi nga koncepti i formalizimit të ekonomisë si fjalë e ditës te ai i rregullit të ditës, pra ekonomi dhe biznese formale si pjesë e rregullit dhe veprimtarisë së përditshme.

Në këtë kontekst, askush më shumë se bankat nuk e kanë pritur me interesim aksionin anti – informalitet të qeverisë shqiptare, por si vendim-marrëse të ftohta ato duan të kenë përballë klientë të qetë, të motivuar, të qartë, me shpirt

të fortë sipërmarrës, e gjithashtu, të edukuar me njohuri të përshtatshme financiare dhe fiskale. Bankat do vijojnë të japin kontributin e tyre të çmuar dhe të pakushtëzuar, jo vetëm në këtë betejë, por në gjithë luftën për formalizim, në rolin e tyre unik si partner i baraslarguar nga qeveria dhe biznesi. Megjithatë, për gjithkënd duhet të jetë e qartë se, formalizimi i ekonomisë është një sistem i domosdoshëm reformash, jo pak të dhimbshme e komplekse, veçanërisht në kushtet e ekonomisë dhe shoqërisë shqiptare, por ai nuk mund të reduktohet dhe identifikohet thjesht me një aksion taksidarësh, që prodhon më shumë të ardhura fiskale dhe xhiro të faturuar. Kjo e fundit është vetëm njëra nga betejat e kësaj lufte të gjatë, por realisht jo e vetmja e jo ndër më të rëndësishmet, kur vendoset përkrah betejave ndaj papunësisë, varfërisë, rritjes ekonomike dhe konsumit, konkurrueshmërisë së ekonomisë dhe mirëqenies së kombit, si pjesë të formalizimit të ekonomisë kombëtare dhe zhvillimit të saj mbi themele solide dhe të qëndrueshme. Kjo është një rrugë e gjatë dhe të gjithë duhet ta pranojmë se *Roma non fuit una die condita* (Roma nuk u ndërtaua për një ditë)!

¹ Zv.Rektor për Procesin Akademik, UET.



nga **Z. Gideon Van Den BROEK**
Drejtor i Përgjithshëm,
BANKA NDËRKOMBËTARE TREGTARE (ICB)

Bankat përballë informalitetit

Si duhet të veprojnë?



Duhet të jemi të vetëdijshëm për një sërë pengesash, ku është qartësisht e vështirë të arrihet objektivi i formalizimit në masën 100% në janar 2018, nëse pronarët e bizneseve nuk janë sa dhe siç duhet të pajisur e të orientuar me mjetet dhe instrumentet e nevojshme, për të arritur një nivel të përcaktuar formalizimi.



Para së gjithash, në këtë artikull paraqitet opinioni i Bankës Ndërkombëtare Tregtare, si një institucion financiar, por ajo nuk mund të jetë zëdhënësja dhe për institucionet e tjera financiare, që ushtrojnë veprimtari në Shqipëri. Në mirëpresim si institucion të gjithë përpjekjet e ndërmarra nga qeveria shqiptare për uljen e informalitetit në ekonominë shqiptare. Transparenca në veprimtaritë e përditshme është kritike në marrëdhëniet e tyre me institucionet financiare; kjo vlen jo vetëm për bizneset, por edhe për individët. Bankave do t'u duhet të luajnë një rol të rëndësishëm në këtë proces tranzitor, por ato janë gjithashtu pjesë e këtij mozaiku. Sigurisht që përmbushja e objektivave të vendosura gjatë fushatës kundër informalitetit, do të kërkojë domosdoshmërisht një bashkëpunim midis të gjithë palëve të interesuara.

Lidhur me sektorin bankar, informaliteti lidhet kryesisht në kreditimin e bizneseve në Shqipëri. Për çdo analizë kredie ka rëndësi kritike krijimi i një panorame të qartë e të detajuar rreth ecurisë financiare të një shoqërie. Fakti që bankat detyrohen të përshtatin

vlerësimet aktuale për kredi, bazuar në analizën e pasqyrave financiare të deklaruara dhe atyre të vet shoqërisë, nuk justifikon ekzistencën e një ekonomie informale. Faktikisht, ajo tregon se bizneset - dhe këtu flasim në terma përgjithësues - nuk janë ende të gatshëm të shkëputen nga mentaliteti i ditëve të para të tregut të lirë dhe të pranojnë faktin që, pagesa e taksave në përputhje me ecurinë e tyre, është detyrë qytetare, e cila në fund të fundit kontribuon në formimin e një pozite më të mirë ekonomike të të gjithë kombit. Kjo përfaqëson të ashtuquajturin "sport shqiptar" të minimizimit të tatimeve të paguara gjatë gjithë kohës, i cili të kthen në rrënjën e faktit të thjeshtë që pronarët e bizneseve janë skeptikë lidhur me përdorimin e të ardhurave të mbledhura nga qeveria përmes tatimeve dhe taksave. Dilema është thjeshtë: "Pse të paguash nëse nuk e ke të qartë atë që merr në kthim prej tatimeve dhe taksave që paguan?" ky është një element thelbësor që meriton vëmendje të veçantë, lidhur me përpjekjet për të luftuar dhe për të ulur informalitetin. Kalimi nga ekonomia informale në atë

formale është një rrugë që meriton të merret seriozisht, pasi ajo kërkon një plan të qartë, me objektiva të mirë-përcaktuara për të gjithë grupet e interesit. Kjo kërkon domosdoshmërisht një marrëdhënie të harmonizuar midis të gjithë aktorëve (Drejtoria e Tatimeve, Shoqata Shqiptare e Bankave, Banka e Shqipërisë, DPPP, organizmat e tjera qeveritare, pronarët e bizneseve, etj.), pasi kjo sipërmarrje duhet të trajtohet si një program shumëvjeçar. Më 2 korrik 2015, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, përcaktoi për bankat një objektiv që, duke filluar nga janari i vitit 2018, ato duhet të mbështeten vetëm në deklaratat e bizneseve të dorëzuara pranë zyrës së tatim-taksave, gjatë procesit të vlerësimit të kërkesave të këtyre të fundit



Përgjithësisht, lëvizja drejt një shkalle më lartë formalizimi do të ketë një ndikim pozitiv mbi shëndetin e ekonomisë dhe lehtësinë e kreditimit për bizneset.



për kredi. Bankat janë një mekanizëm që mund të disiplinojë përdorimin e pasqyrave të rregullta financiare, por kjo mund të zbatohet vetëm për ato biznese që kanë aktualisht nevoja për financim. Bankat, nën kujdesin e Shoqatës Shqiptare të Bankave dhe në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë, mund të përcaktojnë masa të thjeshta se deri në cilin nivel mund të lejohen të pranojnë pasqyrat e brendshme financiare të bizneseve, përkrah atyre të deklaruara. Aktualisht kufiri është vendosur në 10 % të kapitalit aksionar të bankës, që do të thotë se çdo hua më e madhe se 10 % e kapitalit të bankës do të jepet vetëm mbi bazën e pasqyrave të deklaruara financiare. Bankat mund të operojnë duke u nisur nga ky tregues, por huadhënia, më shumë se sa e lidhur me nivelin e kapitalit të ndonjë institucioni financiar, duhet të lidhet me shkallën e formalizimit të klientit të mundshëm. Nga ana tjetër, ulja e informalitetit duke filluar nga viti 2018 është një objektivi i shprehur qartë, por duhet të jetë e qartë se nuk kalohet nga 0 në 100 % formalizim, brenda natës. Nevojitet një planifikim i kujdesshëm dhe të gjithë grupet e interesit duhet që bizneseve t'ia komunikojnë qartë pritshmëritë e tyre.

Tashmë është e nevojshme që pronarët e bizneseve të orientohen dhe trajnohen për të rritur shkallën e formalizimit të tyre në një nivel të paracaktuar (është në dorë të pronarit të biznesit të lëvizë më shpejt në këtë drejtim), duke përcaktuar një përqindje maksimale të pranimit të pasqyrave të brendshme financiare, për shembull: duke filluar janari 2016, bankat të mund t'i marrin parasysh këto pasqyra deri në masën 50 % të atyre të deklaruara, nga janari 2017, deri në 25 % dhe nga janari 2018, 0%! Kjo qasje praktike duhet të bëhet praktikë e tregut (e pranuar nga të gjitha bankat), për të siguruar të njëjtat rregulla loje për të gjithë. Miratimi i këtyre masave nga bankat mund të aprovohet dhe nga Banka e Shqipërisë, gjatë auditimeve të saj të rregullta në bankat tregtare në Shqipëri. Pavarësisht se kjo qasje e thjeshtë do të

lehtësojë pranimin nga ana e bankave për të njohur pasqyrat e deklaruara financiare, ajo do të ndikojë vetëm mbi klientët që kanë nevoja për financim. Këtu është i nevojshëm koordinimi i të gjithë grupeve të interesit, për të siguruar që një masë e tillë të mbulojë 100% të bizneseve. Pronarët e bizneseve do të kërkojnë mbështetje për t'u përballur me këtë rritje të nivelit të formalitetit, e në këto kushte ata do të duhet të pajisen me instrumentet dhe aftësitë përkatëse për këtë qëllim – veçanërisht bizneset e vogla (më shumë gjasa ato që janë regjistruar së fundi, por që kanë qenë aktive në treg për vite me rradhë) të cilave u mungojnë edhe kapacitetet më minimale për mbajtjen e regjistrimeve dhe librave kontabël. Rrjedhimisht, edukimi është çelësi i suksesit, i cili duhet të kombinohet me instrumente kontabël, në mënyrë që bizneset të sigurojnë mjetet e duhura në këtë drejtim. Bankat mund të luajnë një rol trajnues në këtë drejtim, gjatë procesit të kërkesave për hua nga klientët e mundshëm; natyrisht që mund të mendohen edhe metoda të tjera të edukimit të pronarëve të bizneseve.

Përgjithësisht, lëvizja drejt një shkalle më lartë formalizimi do të ketë një ndikim pozitiv mbi shëndetin e ekonomisë dhe lehtësimin e kreditimit për bizneset. Aktualisht, vlerësimi i një biznesi duke përdorur si pasqyrat e brendshme financiare, ashtu dhe ato të deklaruara është e mundimshme dhe nuk jep gjithmonë një panoramë të plotë të stabilitetit financiar të biznesit. Për këtë arsye, procesi i analizës së huas është i zgjatur në kohë (në varësi edhe të madhësisë së huas) dhe aksioni për formalizim do ta thjeshtojë procesin e huadhënies, duke u shkurtuar kohë, si bankave ashtu dhe klientëve.

Një efekt shtytës pozitiv në luftën kundër informalitetit do të japë dhe përmirësimi i procesit të raportimit dhe regjistrimit të pagave. Pronarët e bizneseve do të duhet të përfshijë në raportimet e tyre pagat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, të paguara realisht për stafet e tyre. Kjo është themelore për të stimuluar shpenzimet e konsumatorëve, d.m.th. kreditimin

e konsumatorit; me pak fjalë është mundësia që ka individit të dëshmojë nivelin e të ardhurave të tij. Gjendja aktuale e pagesave të pagave me para' në dorë, apo një kombinim i parave në dorë dhe transfertave bankare (normalisht në madhësinë e të ardhurave minimale) jo vetëm që dëmton mbrojtjen e të punësuarit me pagë (ku dhe sigurimet shoqërore nuk janë në përputhje me nivelet aktuale të pagave), por i pengon ata edhe në procesin e aplikimit për një hua konsumatore. Nisur nga fakti që bankat do të njohin si potencial të të ardhurave mujore të individit vetëm të ardhurat e gjeneruara dhe të kanalizuaru nëpërmjet llogarive bankare, edhe nëse klienti siguron të ardhura shtesë në formën e parave në dorë, ato nuk njihen dhe kjo zvogëlon mundësitë që ai/ajo të kualifikohet për të marrë një hua konsumatore. Kjo është një profeci vet-përmbushëse, pasi pagat e deklaruara më mirë nëpërmjet llogarive bankare do të lehtësojnë kreditimin e klientëve, që në kthim lehtëson shpenzimet e tyre, duke ndikuar pozitivisht mbi ekonominë dhe bizneset që operojnë brenda saj.

Në përfundim, veprimet e ndërmarra kundër informalitetit, edhe pse në fazat e hershme të tyre, janë thelbësore për zhvillimin ekonomik të vendit. Duhet të jemi të vetëdijshëm për një sërë pengesash, ku është qartësisht e vështirë të arrihet objektivi i formalizimit në masën 100% në janar 2018, nëse pronarët e bizneseve nuk janë sa dhe siç duhet të pajisur e të orientuar me mjetet dhe instrumentet e nevojshme, për të arritur një nivel të përcaktuar formalizimi. Koordinimi mes palëve të interesuara, dhënia e një mesazhi të unifikuar si dhe parashtrimi i një udhërrëfyese të qartë, me objektiva të auditueshme vjetore, do të lehtësojnë arritjen e suksesit në këtë drejtim. Një gjë e tillë do të nxiste jo vetëm veprimtarinë e kreditimit të biznesit, por do të ndikonte në rritjen e mëtejshme të kreditimit për individët. Bankat patjetër që do të luajnë një rol të rëndësishëm në këtë proces, por sukcesi do të mund të arrihet vetëm në bashkëpunim me të gjithë aktorët e tjerë.



nga Prof. Asoc. Dr. Arben MALAJ
President
INSTITUTI PËR POLITIKA PUBLIKE DHE
MIRËQEVERISJE (IPPM)

Ka shumë referime dhe klasifikime se kush përfshihet në ekonominë informale. E përbashkëta është pagimi i një pjese apo i të gjitha detyrimeve fiskale. Përgjithësisht, paraja informale gjendet në një numër të madh biznesesh, kryesisht individuale dhe të vogla, ndërsa ajo kriminale në një numër gjithnjë e më të vogël. Të parat e cenojnë pak demokracinë, të dytat janë një kërcënim real dhe në rritje. Paratë nga ekonomia e zezë bëhen edhe më të pista dhe kërcënuese kur investohen në politikë, me synim e kapjes së shtetit. Shkalla e lartë e informalitetit në ekonominë tonë e vendos reduktimin e tij në reformat strukturore prioritare, për çdo qeveri. Efektet pozitive kanë të bëjnë me përcjelljen më mirë të politikave monetare, financiare dhe strukturore, në një pjesë më të madhe të ekonomisë.

Nëse pranojmë se informaliteti në vendin tonë është 33-36%¹, kjo nënkupton se, më shumë se 1/3 e veprimtarisë ekonomike ndodhet jashtë mundësi

Formalizimi i Ekonomisë

Një përpjekje shumë komplekse



Një sërë kërkimesh akademike kanë argumentuar se reduktimi i informalitetit duhet të bazohet në një strategji të mirë-studiuar, duhet të jetë afatmesme dhe afatgjatë, duhet të synojë fokusimin të lehtësimit, duhet të jetë integrale dhe të përfshijë sa më shumë faktorë dhe aktorë të zhvillimeve ekonomike dhe sociale.



për të përfituar nga politikat ekonomike, mbështetëse dhe nxitëse. Më shumë se 1/3 kanë qasje të kufizuar në burimet e kreditimit të biznesit të tyre dhe nuk përfitojnë nga skemat e nxitjes së NVM-së. Nëse 1/3 e ekonomisë ka këto pengesa për t'u zhvilluar, e gjithë ekonomia jonë do të rritet poshtë potencialeve të saj, duke krijuar probleme me stabilitetin e

financave publike dhe produktivitetin e ekonomisë.

Aktualisht zhvillimi në një fazë të re të ekonomisë së vendit do të kushtëzohet ndjeshëm në rritjen, qëndrueshmërinë dhe cilësinë e rritjes së ekonomisë. Rritja e aftësisë konkurruese të ekonomisë tonë kushtëzohet nga disa reforma strukturore të rëndësishme, siç janë: (i) shërbimet publike, energji, ujë, transport, ndriçim – të cilat duhet të eliminojnë subvencionimin e tyre të drejtpërdrejt ose të tërthortë, sepse kanë kufizuar burimet buxhetore për financimin më të mirë të arsimit, shëndetësisë, infrastrukturës, bujqësisë dhe turizmit; (ii) reduktimi i shkallës së subvencionimit të deficiteve të skemave të sigurimeve shëndetësore dhe shoqërore, që janë një barrë e rëndë për taksapaguesit shqiptarë. Rreth 460 milionë dollarë të taksapaguesve shqiptarë nuk shkojnë për të rritur investimet publike në sektorët që përcaktojnë cilësinë e zhvillimit ekonomik dhe në uljen graduale të borxhit publik, por subvencionojnë deficitin e skemave të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore; (iii) reformat në menaxhimin e shoqërive dhe agjencive publike – keqmenaxhimi i tyre i shkakton ekonomisë tonë humbje të mëdha, jo vetëm financiare, por edhe në cilësinë e shërbimeve dhe furnizimeve që ato duhet të garantojnë; (iv) grupi i



Reduktimi gradual dhe me logjikë lehtësuese të ekonomisë informale është një qasje me përfitim të dyfishtë edhe për sistemin bankar. Kjo, pasi formalizimi i saj në hapat e para rekomandohet të bëhet nëpërmjet skemave lehtësuese financuese, ku kërkohet bashkëpunimi midis sistemit bankar që krediton me interesa tregtare dhe qeverisë që lehtëson kostot tregtare, nëpërmjet skemave të ndarjes së rreziqeve.



¹ IMF - An Empirical Study of their Impact on Taxpayer Compliance and Administrative Efficiency, May 2015, <https://www.imf.org/external/pubs/ft/wp/2015/wp1573.pdf>.

reformave më të vështira, por edhe më të domosdoshme, është ai i përmirësimit të mjedisit të biznesit. Funkzioni i dobët i shtetit ligjor, mungesa e lirisë së pronës, niveli epidemik i korrupsionit dhe kapja e shtetit – vazhdojnë të mbajnë të shtypur potencialet për rritje ekonomike më të lartë dhe cilësore.

Nëse do i referohemi disa prej indekseve kryesore të skanimit të ekonomive të vendeve të ndryshme në botë, do të ndihmohemi të qartësojmë problemet kryesore dhe do të dallojmë pengesat reale, do të kuptojmë dështimet e përsëritura, gjatë tranzicionit tonë të vështirë. Disa nga këto indekse janë: (1) indeksi i lirisë ekonomike; (2) indeksi i perceptimit të korrupsionit; (3) indeksi i tranzicionit; (4) indeksi të bërit biznes dhe i pagimit të taksave, e sidomos (5) indeksi i konkurrencës globale.

Por si ndikojnë aksione të tilla në klimën e biznesit në përgjithësi e më tej, cili është ndikimi dhe pasoja e një sipërmarrje të tillë në drejtim të kërkesës së biznesit drejt huave bankare? Më lart u argumentua domosdoshmëria dhe dobia e luftës kundër informalitetit. Pra, pas diagnostikimit të gjendjes kritike, hapi tjetër është terapia, shkalla e ndërhyrjes, mjetet dhe kura e domosdoshme, përpara, gjatë dhe pas ndërhyrjes/aksionit. Reforma do të lehtësonte: (i) qartësimin e vizionit (reformë apo aksion); (ii) vendosjen e objektivave dhe treguesve konkretë e të matshëm; (iii) llojin e ndërhyrjes në tre nivele, legjislativ - ligjet dhe aktet nënligjore, institucionet përkatëse, përgjegjëse për zbatimin e reformës dhe përmirësimin e efencës së autoriteteve përkatëse; (iv) shkallën e gradualitetit, për të arritur rezultate të qëndrueshme; (v) raportin midis kulaçit dhe kërbaçit – studimet ndërkombëtare tregojnë se reduktimi i informalitetit do të synohet duke i dhënë prioritet lehtësimit (kulaçit) dhe jo penalizimit (kërbaçit); (vi) do të qartësonte kohëzgjatjen për arritjen e objektivave dhe qëllimeve konkrete; do të parashikonte skemën dhe afatet e monitorimit, si dhe afatet e rishikimit, p.sh. një reformë 5 deri në 7 vite do të duhej të rishikohej dy herë

në vit dhe t'i bëhet rifreskim një herë në vit dhe së fundi, do të qartësonte brenda skemës funksionale të qeverisë, por edhe institucioneve jo-qeveritare, kush bën çfarë dhe kur.

Reduktimi gradual dhe me logjikë lehtësuese të ekonomisë informale është një qasje me përfitim të dyfishtë edhe për sistemin bankar. Kjo, pasi formalizimi i saj në hapat e para rekomandohet të bëhet nëpërmjet skemave lehtësuese financuese, ku kërkohet bashkëpunimi midis sistemit bankar që krediton me interesa tregtare dhe qeverisë që lehtëson kostot tregtare, nëpërmjet skemave të ndarjes së rreziqeve. Formalizimi fut në qarkullim ekonomik pasuri individuale, të cilat duhet të lehtësojnë huamarrjen, për të kaluar në një shkallë më të lartë të veprimtarisë dhe fitimeve të tij. Në këtë drejtim, Banka e Shqipërisë, Shoqata Shqiptare e Bankave, bashkë me shoqata të tjera të biznesit apo donatorë potencial mund të financonin një studim të thelluar të shkaqeve e përmasave të ekonomisë informale, si dhe të strategjisë kombëtare të reduktimit të saj. Eksperiencia të studimeve të tilla gjenden në vende të tjera.

Për sa i përket cenimit të veprimtarisë bankare, kërkesës për hua dhe rritjes ekonomike nga aksione të tilla, nëse ato nuk janë të mirë-studiuara dhe të pashoqëruara me masa të tjera lehtësuese në ekonomi, duhet të dallojmë efektin e menjëhershëm dhe efektin e qëndrueshëm. Këtu ka shumë rëndësi



Shoqatat e biznesit dhe bankave duhet të nxisin studime të thelluara, ato duhet të jenë aktorë në hartimin dhe zbatimin e suksesshëm të reformave strukturore në ekonomi, duhet të përmirësojnë edhe menaxhimin e tyre dhe marrëdhëniet profesionale me biznesin.



ajo që konsiderohet “timing” – pra koha që përzgjidhet për të nisur një reformë, një aksion apo një sipërmarrje. Në këtë këndvështrim, koha e përzgjedhur për një aksion kundër informalitetit ishte e gabuar. Koha për të nisur një reformë që lehtëson informalitetin ishte koha më e mirë, kjo sepse reduktimi i informalitetit, duke u bazuar në lehtësimin e formalizimit, mund të krijonte burime të reja rritje, në një kohë kur rritja është objektiv i më i vështirë për çdo qeveri, sidomos aktualisht kur sfidat sociale janë të rënda. Aksioni kundër informalitetit krijonte trysni për mbyllje të veprimtarive informale, rrit qoftë edhe përkohësisht papunësinë dhe plagë të tjera sociale, ndërsa formalizimi nëpërmjet lehtësimit nuk e krijonte këtë situatë.

Edhe në pjesën e huadhënies duket se “timing-u” nuk është mbajtur parasys, pasi lufta kundër informalitetit u nis me vull në periudhën kur, për shumë arsye, bankat tona tregtare ndodheshin nën kufizime të rrepta lidhur me huadhënien. Jo rastësisht në indeksin e konkurrencës globale të vitit 2014-2015 vështirësia kryesore për biznesin ishte qasja në burime financimi².

Në qoftë se i bëhet një analizë retrospektive rezultateve të aksionit kundër informalitetit kemi disa pasoja shqetësuese, duke filluar nga shkelja rëndë e parimit të proporcionalitetit dhe parimit të shtetit të së drejtës, që nënkupton ndarje, balancë dhe kontroll të pushteteve. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese për ngrirjen e ligjit për procedurat tatimore është një argument plus në këtë debat publik dhe një hap pozitiv në qartësimin e kufijve kushtetuese, që ka çdo qeveri në qeverisjen e vendit të saj.

Masat represive kanë ushqyer pasigurinë dhe, sipas Bankës së Shqipërisë, kanë varfëruar burimet e konsumit, duke u shfaqur edhe në rënien e niveleve të parashikuara të rritjes ekonomike. Këto masa nxitën emigrimet masive dhe rritën aplikimet për të emigruar. Reduktimi i burimeve njerëzore dhe i kapitalit social është sfida më e rëndë e çdo vendi, aq më shumë për vende që në

² World Bank: Shadow Economies All over the World New Estimates for 162 Countries from 1999 to 2007, Policy Research Working Paper 5356, <https://openknowledge.worldbank.org/bitstream/handle/10986/3928/WPS5356.pdf?sequence=1>

WELCOME ABI BANK!



Banka Amerikane e Investimeve

Pjesë e grupit Amerikan **NCH Capital**, me investime globale dhe qendër në NEW YORK.

MIRËSEERDHE ABI BANK!

info:
www.abi.al



të ardhmen e afërt do të përballen me sfida demografike jo të lehta. Shqipëria ka ende mundësi të përdorë më mirë dividendin e saj demografik, përpara se të përballlet me sëmundjen epidemike europiane, të deficitit demografik dhe të rritjes së papunësisë strukturore.

Oponenca jonë (www.ippm.al) për aksionin e qeverisë kundër informalitetit, se si mund të orientohej dhe realizohej më mirë ky aksion dhe cilat mund dhe do të ishin përfitimet e të gjithë grupeve të interesit, përfshirë dhe bankat, u bazuan në studime të institucioneve financiare ndërkombëtare, që kishin studiuar ekonominë informale në 188 vende të botës, për periudhën 1999-2009 dhe në një studim të FMN-së për problematiken e aksioneve të reduktimit të informalitetit, duke absolutizuar në imponimin e përdorimit të kasave.³ Jo vetëm këto dy studime por edhe një sërë kërkimesh akademike kanë argumentuar se, reduktimi i informalitetit duhet të bazohet në një strategji të mirë-studiuar,

duhet të jetë afatmesme dhe afatgjatë, duhet të synojë fokusimin te lehtësimi, duhet të jetë integrale dhe të përfshijë sa më shumë faktorë dhe aktorë të zhvillimeve ekonomike dhe sociale.

Shoqatat e biznesit dhe bankave duhet të nxisin studime të thelluara, ato duhet të jenë aktorë në hartimin dhe zbatimin e suksesshëm të reformave strukturore në ekonomi, duhet të përmirësojnë edhe menaxhimin e tyre dhe marrëdhëniet profesionale me biznesin. Bankat nuk duhet të kërkojnë dhe mbështesin nisma ligjore, deri në Kodin Civil, që prekin parimet themelore dhe të drejtat jetike të çdo individi në marrëdhëniet kontraktuale me bankat dhe çdo entitet tjetër, publik apo privat. Nëse synohet që problemet e bankave tregtare të zgjidhen duke cenuar ose kufizuar këto të drejta, përfitimet e tyre do të jenë të kufizuara dhe të përkohshme.

Bazuar edhe në përvojën personale studimore dhe në mandatet publike, është koha që disa bankierë të ndërgjegjësohen

se, pa ekonomi të shëndetshme nuk ka banka të shëndetshme. Ekonomia rritet më mirë nëpërmjet reformave strukturore që venë në qendër cilësinë e institucioneve të shtetit të së drejtës. Ristrukturimin pozitiv të ekonomisë së vendit tonë mund ta bëjnë më mirë ndërmjetësit financiarë, duke shpërndarë dhe rishpërndarë kursimet/depozitat dhe fitimet drejt investimeve publike e private më produktive.

Së fundi, qeveria duhet të përmbushë detyrimet e saj në reformat që rrisin dhe garantojnë lirinë e pronës, që reduktojnë pengesat nga korrupsioni dhe kapja e shtetit, që eliminojnë kostot shtesë të mungesave kritike për biznes siç janë aksesin në furnizimin me drita, ujë, infrastrukturë fizike, ligjore dhe tregtare. Sa më i lehtësuar dhe i përmirësuar të jetë mjedisi i biznesit, aq më pak kohë për burokraci dhe shumë kohë për sukses. Sa më pak kosto nga pengesat për biznes, aq më shumë burime financimi për t'u rritur dhe modernizuar.



³ World Bank Doing Business 2016 Measuring Regulatory Quality and Efficiency <http://www.doingbusiness.org/data/exploreeconomies/albania/-/media/giawb/doing%20business/documents/profiles/country/ALB.pdf>



Z. Andi BALLTA

Drejtor i Përgjithshëm

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE (ABI)

Banka Amerikane e Investimeve (ABI)

Një sinergji e re midis bankës dhe jobankës



Objektivi ynë i parë është përgatitja e bankës për të funksionuar sipas strategjisë së aksionarëve të rinj, duke u mbështetur në rrjetin ekzistues të degëve në të gjithë qytetet kryesore të vendit, sistemet informative shumë të avancuara, stafin e kualifikuar dhe me eksperiencë të gjatë në bankë dhe marrëdhënien unike me “Tranzit Finance”.



BANKIERI: Çfarë nënkupton për tregun bankar shqiptar blerja e një banke tregtare nga një fond privat kapitalesh?

Tregu bankar shqiptar ka një eksperiencë të gjatë dhe shumë pozitive me bankat e blera nga fonde private kapitalesh. Padyshim, Banka Amerikane e Shqipërisë ishte historia e parë e suksesit të fondeve të investimeve dhe banka që hodhi themelet e bankingut modern në Shqipëri. Për më shumë, kjo bankë solli frymën amerikane të të bërit biznes (si: besimin dhe sigurinë në sistemin bankar dhe respektin ndaj klientit), në një kohë kur ishte shumë e nevojshme për tregun shqiptar të dilte nga kriza ekonomike dhe forcimit të besimit ndaj institucioneve financiare, pas dështimit të skemave piramidale, në vitin 1997. Historia tjetër pozitive është Banka Kombëtare Tregtare, që është kthyer sot në bankën më të madhe në Shqipëri. Nuk është rastësi që BKT ka një nga nivelet më të ulëta të huave me probleme. Një fond investimesh ka

një lidhje shumë të ngushtë aksionar – punonjës – klient. Punonjësit ndihen shumë më të motivuar t’i shërbejnë klientëve, pasi trajtohen shumë më ndryshe, pra ka besim më të madh dhe përgjegjësi më të madhe të punonjësve nga aksionarët.

Zgjerimi i “NCH Capital” në Shqipëri sjell një diversifikim shumë pozitiv të investuesve të tregut bankar dhe zgjeron eksperiencën pozitive të deritanishme me fondet e investimit. Si një fond i madh, me eksperiencë të gjatë rajonale dhe globale, e me njohje të gjatë të tregut shqiptar, “NCH Capital” ka për qëllim të përdorë Bankën Amerikane të Investimeve, ABI, si një platformë për investime të tjera në ekonominë shqiptare. Vendi ynë dhe rajoni po dalin nga një krizë e gjatë ekonomike, e shkaktuar nga pasojat e krizës financiare globale të vitit 2008. Kohët që po kalojmë kanë një ngjashmëri ciklike me fillimet e viteve 2000, pavarësisht se arsyet e krizës së 1997-ës dhe 2008-ës janë të ndryshme. Ne presim një rritje

ekonomike në vitet në vazhdim dhe vlen të përmendet se, edhe BERZH-i parashikon një rritje ekonomike 3.8% të PPB-së në 2016-ën.

BANKIERI: Çfarë risish synon të sjellë ABI në tregun bankar shqiptar?

ABI synon të jetë më e shpejtë dhe fleksibël në tregun bankar, në dhënien e shërbimeve tradicionale bankare dhe gjithashtu në disa shërbime të tjera të reja, që do të komunikohen për publikun gjatë vitit 2016. Objektivi ynë i parë është përgatitja e bankës për të funksionuar sipas strategjisë së aksionarëve të rinj. Kjo strategji mbështetet në rrjetin ekzistues të degëve në të gjithë qytetet kryesore të vendit, sistemet informative shumë të avancuara, stafin e kualifikuar dhe me eksperiencë të gjatë në bankë dhe marrëdhënien unike me “Tranzit Finance”. ABI është padyshim banka më likuide në treg dhe kjo krijon sigurinë më të lartë bankare për depozituesit dhe mundësitë më të mëdha për huamarrësit.

BANKIERI: Cili do të jetë tipari dallues i ABI-t në këtë treg?

Ne synojmë të jemi më të gatshëm dhe më të shpejtë në plotësimin e kërkesave të klientëve, që nuk janë interesante për bankat e mëdha, si dhe dhënien e disa shërbimeve shtesë, që nuk jepen për momentin në tregun bankar në Shqipëri. Ne do risjellim sigurinë, optimizmin, ritmin, kujdesin dhe respektin ndaj klientit, që janë të lidhura ngushtë me të qenit “Amerikan”.

BANKIERI: Pse Shqipëria është një treg tërheqës për fondin privat të kapitalit NCH?

Shqipëria ka qenë qendra e NCH-së për Ballkanin Perëndimor dhe Greqinë që prej 2008-ës, pasi Shqipëria është një vend me mundësitë më interesante investuese në rajon. Mbetet shumë domethënës dhe mbresëlënës fakti se si ekonomia shqiptare ka përparuar, pavarësisht nga demografia e vogël dhe izolimi historik ekonomik. Shqiptarët janë kombi më optimist për të ardhmen dhe me më pak pretendime. Ky është një avantazh konkurrues shumë i rëndësishëm dhe që shpesh nënvlerësohet. Shumë nga tiparet e tregjeve më të përparuar të punës (p.sh. Nju Jorku), ne i shohim në Shqipëri. Ekspozimi rajonal dhe global i profesionistëve të lartë dhe të mesëm sjell një përmirësim të përhershëm të cilësisë së ecurisë, që vazhdon të rritet më shpejt se niveli i pretendimeve.

Siç e përmenda dhe më parë, rritja ekonomike në 2016-ën do të jetë afërsisht 4%. Gjatë 2015-ës ne kishim një rritje të kënaqshme ekonomike në Shqipëri. Shitja shumë e suksesshme e Eurobond-it në 2015-ën është një tregues i lartë besimi i tregjeve të huaja për ekonominë shqiptare. Reformat kundër informalitetit dhe fokusi në sektorët e rëndësishëm të ekonomisë do kenë ndikim pozitiv afatgjatë për sistemin bankar dhe ekonominë shqiptare në tërësi. Shqipëria vazhdon të mbetet treg interesant dhe në zhvillim, me objektiva të qarta drejt hyrjes në Bashkimin Europian.

Guvernatori i Bankës së Shqipërisë Z.Gent Sejko dorëzon zyrtarisht liçencën për Bankën Amerikane të Investimeve

Në një ceremoni të organizuar në mjediset e Galerisë Kombëtare të Arteve në datë 4 dhjetor 2015, Z. Gent Sejko, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, i dorëzoi liçencën për ushtrimin e veprimtarisë bankare Z. Lorenzo Roncari, Kryetar i Bordit të Bankës dhe Z. Andi Ballta, Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv i Bankës Amerikane të Investimeve, ne vijim miratimit të blerjes së Bankës Crédit Agricole në muajin tetor 2015. Këtë ceremoni e nderuan me pjesëmarrjen e tyre: Z. Edi Rama, Kryeministër i Shqipërisë; Z. Donald Lu, Ambasador i SHBA-së në Shqipëri; Z. Gregory Katz, përfaqësues i lartë i investuesve amerikanë të NCH Capital Inc.; Z. Rezzo Schlauch; Z. Mark Crawford dhe anëtarë të tjerë të Bordit të Bankës.

Gjatë fjalës së tij, Kryeministri i Shqipërisë, Z. Edi Rama u shpreh: “Ky investim do të jetë një nxitës i fortë i kreditimit dhe e kthen bankën e sapoliçensuar në një shembull tërheqës për investuesit, që do të nxisë pastaj të tjerët të ndjekin të njëjtën rrugë”.

Ndërkohë, Z. Andi Ballta, Drejtor Ekzekutiv i Bankës Amerikane të Investimeve, nënvizoi se Banka Amerikane e Investimeve synon të kthehet në një faktor të rëndësishëm në tregun bankar shqiptar, me produkte e shërbime konkurruese dhe novatore për klientët.





Zj. Ardita SEKNAJ

Sekretare e Përgjithshme
DHOMA NDËRKOMBËTARE E
TREGTISË – KOMITETI KOMBËTAR
PËR SHQIPËRINË (ICC ALBANIA)

Si tregtia ndërkombëtare ashtu dhe sektori financiar janë motorë të rëndësishëm të rritjes në ekonomitë e sotme. Tregtia është ndoshta një nga veprimtaritë më të vjetra të shoqërisë njerëzore, por funksioni i saj themelor mbetet i pandryshuar përgjatë gjithë historisë. Sektori financiar është kritik për funksionimin e ekonomisë në tërësi dhe bankat janë në qendër të sistemit financiar.

Shqipëria është pjesë e botës së globalizuar dhe pasiguria është e pranishme në çdo aspekt të zhvillimeve ekonomike dhe atyre të përditshme. Rritja e rëndësisë së këtyre dy sektorëve në ekonominë shqiptare përforcohet nga pesha e tyre në PBB, gjatë dekadave të fundit. Sipas INSAT dhe Ministrisë së Financave, raporti i tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe shërbimeve ndaj PBB-së është rritur nga rreth 38% në vitin 2003, në rreth 58% në vitin 2014. Raporti i transaksioneve financiare (për-

Financimi i tregtisë: A ka kërkesë për të në Shqipëri?



“Pa financimin e tregtisë, nuk ka zgjerim të tregtisë; pa tregti nuk ka nevojë për financim të tregtisë”

Vincent O'Brien¹



fhirë bankat, sigurimet dhe pasuritë e patundshme) ndaj PBB-së ka ruajtur një përqindje të qëndrueshme gjatë pesë viteve të fundit, në rreth 7%. Qendra Ndërkombëtare për Tregti e Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT) pranon se tregtia e Shqipërisë, pavarësisht arritjes së një prej rritjeve më të forta në Europën Juglindore, ende pengohet nga qasja e kufizuar në financim, transporti i pazhvilluar dhe infrastruktura energjetike, si dhe mjedisi i vështirë rregullativ dhe i biznesit. Nga sa më sipër, është e rëndësishme të theksohet se mirëfunksionimi i sistemit financiar mbështet tregtinë ndërkombëtare, duke minimizuar dhe mbuluar rreziqet e saj kryesore, të tilla si: rreziku i kursit të këmbimit, rreziku transportit dhe rreziku politik.

Në rolin e ndërmjetësve, institucionet financiare luajnë një rol të rëndësishëm në lehtësimin e tregtisë ndërkombëtare, nëpërmjet zhvillimit të instrumenteve që ofrojnë të ashtuquajturën financimin e tregtisë. Financimi i tregtisë njihet si ofrimi i çfarëdo forme të financimit që mundëson realizimin e një veprimtarie tregtare. Financimi i tregtisë përfshin veprimtari të tilla, si: huadhënia, emetimi i letër-kredive, faktoringu, huaja për eksporte dhe sigurimi i tyre. Financimi i tregtisë ofrohet nga bankat

tregtare, agjencitë zyrtare të huave për eksport, bankat shumëpalëshe të zhvillimit, shoqëritë e sigurimeve, furnizuesit dhe blerësit, në forma të ndryshme. Format e drejtpërdrejta përfshijnë: hua për financimin e blerjeve që lidhen me tregtinë, parapagimet nga blerësit dhe pagesat e vonuara nga shitësit. Mbështetja e tërthortë vjen përmes instrumenteve të ndërmjetësve financiarë, në formën e sigurimeve, garancive dhe huadhënies me kolateral llogaritë e arkëtueshme. Shumica e këtyre kontratave kërkojnë një kolateral të caktuar. Financimi i tregtisë është një proces që përfshin jo vetëm blerësin, shitësin dhe bankat, por dhe shoqëritë e sigurimeve, ndërmjetësit e transportit, shoqëritë transportit, tregtarët konsolidues, shoqëritë e inspektimit dhe subjektet qeveritare, që përfshihen me çdo dërgesë. Kështu, gjatë procesit të vlerësimit të një transaksioni për financim të tregtisë, institucionet financiare marrin në konsideratë shumë palë dhe faktorë. Instrumentet e ofruara për financimin e tregtisë janë të ndryshme për institucione të ndryshme financiare, në varësi të perceptimit të llojit dhe madhësisë së rrezikut që përmban transaksioni; të ndarjes së rrezikut dhe përpjekjes për reduktimin e rrezikut midis eksportuesve, importuesve dhe ba-

¹ Anëtar i Komitetit Ekzekutiv të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC) & Kryetar i Grupit të Punës për Inteligjencën e Tregut, të Komisionit të Bankingut, ICC.

nkave të tyre; si dhe në varësi të kostove për reduktimin e rrezikut.

Bankat ofrojnë financim përmes linjave të tyre të huas për kapital qarkullues, ose linja të tjera afat – shkurtra, nëpërmjet emetimit të garancive bankare, letër-kredive, skontimit të dokumenteve, apo instrumenteve të tjera të lidhura me financim e strukturuar të tregtisë. Shoqëritë e sigurimeve, gjithashtu, ofrojnë sigurim ndaj rreziqeve të caktuara, që lidhen me procesin e tregtisë. Instrumentet e sigurimit përfshijnë: sigurimin e transportit dhe huas për eksport, por edhe kontrata me afat (për t'u siguruar ndaj ndryshimeve në kursin e këmbimit). Disa klauzola të tjera mund të ofrojnë sigurim kundrejt mos-përmbushjes së detyrimit nga shitësi dhe rreziqet që vijnë nga ndryshimet e politikave qeveritare. Pa këto instrumente financiare, tregtia ndërkombëtare do të ishte shumë më e rrezikshme e me pengesa. Financimi i tregtisë është një proces kompleks, që përfshin nga 6 deri në 12 palë në një transaksion tipik, të cilët kanë përgjegjësi, interesa dhe profile rreziqesh të ndryshme, kështu që grumbullimi dhe harmonizimi i të gjithë këtyre elementëve në një ose dy faqe, është një detyrë shumë e vështirë. Faktorët që ndihmojnë të gjitha palët e interesuara të punojnë sipas kushteve dhe standardeve të përbashkëta janë pikërisht rregullat që menaxhojnë dokumentacionin në fjalë. Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë ka luajtur, për më shumë se 80 vjet, një rol shumë të rëndësishëm në lehtësimin e tregtisë dhe financave ndërkombëtare, duke prodhuar rregulla dhe udhëzime ndërkombëtare uniforme, për të ndihmuar të gjitha palët të kenë rezultate të mira. Rregullat uniforme për garancitë me kërkesë, rregullat dhe praktikat uniforme për huat dokumentare, për arkëtimet dokumentare dhe rregullat më të fundit për forfaiting-un, ose rregullat për detyrimet e pagesave kanë shërbyer për përmirësimin e transaksioneve të tregtisë ndërkombëtare.

Në kontekstin shqiptar, financimi i tregtisë përgjithësisht konsiderohet si një linjë plotësuese e biznesit, për huat

bankare ndaj korporatave apo NVM-ve (Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme). Institucionet financiare, nuk kanë strategji të zhvilluara apo linja prioritare, me fokus të veçantë mbështetjen e tregtisë. Megjithatë, duhet theksuar se, gjatë dekadës së fundit, shumica e bankave që operojnë në Shqipëri kanë caktuar struktura dhe staf të përkushtuar, për t'u angazhuar me transaksionet e financimit të tregtisë. Arsyet mund të jenë të ndryshme; mund të jetë një çështje kulture e të bërit biznes, apo për shkak të faktit se rreziku i perceptuar nga bankat për huadhënien në madhësi të vogël është i lartë, për shkak të kostove të administrimit, mbullimi me kolateral ose mjedisi ekonomik dhe i biznesit në vend, politikat tregtare, burimet njerëzore, etj. Një nga objektivat e këtij shkrimi ishte sigurimi i



Sipas INSTAT, NVM-të përbëjnë më shumë se 90% të bizneseve, pra mund të thuhet hapur se financimi i tregtisë, ose huat e lidhura drejtpërdrejt me transaksionet e tregtisë ndërkombëtare, do të japin një kontribut të rëndësishëm për zhvillimin dhe qasjen në financimin e tregtisë, e cila paraqet rëndësi të veçantë për ndërmarrjet e mesme dhe të vogla NVM në vendin tonë.



disa të dhënave për financimin e tregtisë nga institucionet financiare në Shqipëri, për të bërë një analizë më të thellë të zhvillimeve aktuale në këtë fushë. Por, mungesa e të dhënave kombëtare për financimin e tregtisë paraqet kufizime që pengojnë një analizë të thelluar të tregut. Konsiderohej likuid dhe mirëfunksional e si i tillë, nuk tërhiqte shumë vëmendjen e politikë-bërësve. Sektori ka përjetuar dhe periudha stresi, veçanërisht pas falimentimit të Lehman Brothers si dhe në fund të vitit 2011, kur shtrëngesat e financimit nga bankat europiane prodhuan shqetësime për ndërprerje

të mundshme të këtyre financimeve. Shumë organizata që vëzhgojnë prirjet në tregtinë ndërko-mbëtare, zhvillimet ekonomike dhe sektorët financiarë, filluan të kryejnë vrojtme në këtë fushë, për të kuptuar më mirë marrëdhëniet e ndryshme ndërmjet faktorëve kyç në këtë drejtim.

Shqipëria është një ekonomi e vogël në zhvillim me tregti ndërkombëtare në raport të madh me prodhimin vendas, siç paraqitet dhe nga raporti i mësipërm i tregtisë ndaj PBB-së. Sipas INSTAT, NVM-të përbëjnë më shumë se 90% të bizneseve, pra mund të thuhet se financimi i tregtisë, ose huat e lidhura drejtpërdrejt me transaksionet e tregtisë ndërkombëtare, do të japin një kontribut të rëndësishëm për zhvillimin dhe qasjen në financimin e tregtisë, e cila paraqet rëndësi të veçantë për NVM në vend. Informacionet sasiore do të promovonin të dhënat empirike, si një mbështetje e mirë për zhvillimin e strategjisë mbi tregtinë. Sugjerohet që, shoqatat e industrisë të zgjerojnë bashkëpunimin me organizata të tjera ndërkombëtare, në kryerjen e studimeve të veçanta, duke u ofruar politikë-bërësve dhe lojtarëve një panoramë më të plotë rreth potencialit dhe zhvillimeve të financimit të tregtisë në vend. Anketa Globale e ICC-së për Financat dhe Regjistrin e Tregtisë 2015, paraqet një rritje të kërkesës për produktet që mbulojnë rrezikun tregtar, që do të thotë rritje e biznesit dhe atë ardhurave nga tarifat për bankat e angazhuara në financimin e tregtisë. Financimi i tregtisë është kryesisht një biznes për NVM-të, por mesazhi themelor është se ka një perceptim në rritje të rreziqeve tregtare, bankare, dhe të vendit, në tregjet e tregtisë botërore. Një raport i tillë i përshtatur në nivel kombëtar, mund të bëhet mjet i dobishëm që i lejon politikë-bërësit, rregullatorët dhe institucionet financiare të identifikojnë boshllëqet në disponibilitetin e financimit të tregtisë, për bankat lokale dhe klientët e tyre. Bashkëpunimi i ofruar nga burimet e informacionit, si: bizneset, institucionet financiare dhe institucionet qeveritare përkatëse, mbetet imperativ për përmbushjen e këtyre objektivave.

90 VJET



TRASHËGIMI

Së bashku
për ditë
akoma më
të mira



BANKA KOMBETARE TREGTARE



4 22 66 288 | www.bkt.com.al



nga Av. Ermal NAZIFI, LLM, PhD²

Konsulent ligjor

Qendra për Ofrimin e Shërbimeve
Publike të Integruara – ADISA

Autoriteti i Konkurrencës po kryen një hetim të përgjithshëm të tregut për hapjen e procedurës së hetimit të përgjithshëm në sektorin bankar. Pritet që ky hetim të përfundojë brenda 3 mujorit të parë të vitit 2016. Ky hetim është hapur me motivimin se tregu bankar ka norma relativisht të larta fitimi. Konkretisht, në vendimin nr.373, datë 16.09.2015, “Për hapjen e procedurës së hetimit të përgjithshëm në sektorin bankar”, ndër të tjera, theksohet se:

“Gjatë viteve të fundit tregu bankar paraqet karakteristikat e një tregu me norma relativisht të larta fitimi, në kushtet e stanjacionit të kreditimit; interesa shumë të ulëta të depozitave (deri në 0.55% mbi bazë vjetore në nivelin e inflacionit); diferenca (spread) relativisht të larta mes interesave të kredive dhe depozitave; tendencës në rritje të interesave të letrave me

Fitimet e bankave... në shënjestër!¹



Në rast se do të provohej pozita dominuese, atëherë Autoriteti i Konkurrencës duhet të provojë abuzimin me këtë pozitë, në formën çmimeve të padrejta, të cilat kanë çuar në një fitim të lartë. Kjo, pasi thjesht fitimi i lartë nuk mjafton për të provuar një sjellje anti-konkurrese!



vlerë të qeverisë, kryesisht afatgjata (obligacione) në kushtet e një politike lehtësuese monetare dhe kur norma bazë e interesit të depozitave kanë tendencë në rënie; ka rritje të komisioneve për pagesat kryesisht brenda vendit etj.”

Çfarë përfaqëson një hetim i përgjithshëm?

Hetimet e përgjithshme, në dallim nga hetimet paraprake dhe të thelluara, që kryhen nga Autoriteti i Konkurrencës, nuk kanë si qëllim parësor zbulimin shkeljeve të konkurrencës dhe dënimin e “keqbërësve” (në terminologjinë ndërkombëtare nuk njihen me termin “hetime” (investigations), por me termin “inquiry”, në kuptimin e mbledhjes së informacionit).

Qëllimi kryesor i këtyre hetimeve është që të përmirësojë mënyrën e funksionimit të tregut për konsumatorët dhe vetë konkurrentët, duke identifikuar problemet e konkurrencës në treg. Këto hetime të përgjithshme zbulojnë dhe analizojnë këto probleme, duke studiuar veçanërisht strukturën e tregut, natyrën e konkurrencës dhe nëse ka, shkaqet e kufizimeve të konkurrencës. Një hetim i tillë mund të sjellë disa rezultate:

a) identifikon ato çështje që kanë

nevojë të trajtohen, për të përmirësuar konkurrencën në tregun përkatës, ose

b) vëren se në treg mund të ketë shenja të kufizimit, apo shtrembërimin të konkurrencës, në formën e praktikave



Provimi i pozitës dominuese individuale duket se është tejet i vështirë, duke pasur parasysh ndryshimet në pjesët e tregut të bankave më të mëdha me një konkurrencë të fortë midis tyre, apo faktorë të tjerë, që përcaktojnë këtë pozitë. Nga ana tjetër, të provosh një pozitë dominuese kolektive është tepër problematike, si në teori ashtu edhe në praktikë. Kjo pozitë nuk mund të merret e mirëqenë nga Autoriteti i Konkurrencës, pasi kërkohet që të provohet mungesa e konkurrencës dhe një sjelljeje uniforme e shoqërive tregtare.



¹ KUJDES! Ky artikull sjell informacion për ligjin nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i përditësuar, me qëllim kuptimin më të mirë të tij, por nuk përbën, në asnjë mënyrë, një interpretim përfundimtar të ligjit e nuk mund të zëvendësojë konsulentin ligjorë e profesionale.

² Ish – këshilltar i Komisionit të Konkurrencës në AUTORITETIN E KONKURRENCËS.

Mendimet e shprehura në artikull janë të autorit dhe nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtar të asnjë institucioni.

anti-konkurrese, duke çuar në hapjen e hetimit paraprak e të thelluar.

Eventualisht, nëse konstatohen sjellje anti-konkurrese, subjektet përgjegjëse mund të dënohen me gjoba të rënda, deri në 10% të xhiros vjetore të vitit parardhës.

A përbëjnë “fitimet relativisht të larta” të bankave shqiptare shkelje të konkurrencës?

Sipas ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, dy janë shkeljet kryesore të tij: abuzimi me pozitën dominuese dhe marrëveshjet e ndaluara. Sipas ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, ndalohen të gjitha marrëveshjet, të cilat kanë si objekt, ose si pasojë, pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg.

Duke besuar se tregu bankar është një treg me një luftë të ashpër për të marrë klientë nga njëri - tjetri, me operatorë shumë seriozë, të cilët i kuptojnë pasojat e shkeljes së ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, mendoj se gjasat për marrëveshje të ndaluara janë të vogla, ose të paqena.

Për sa i përket abuzimit me pozitën dominuese, ligji përcakton se ndalohet çdo abuzim nga një ose me shumë ndërmarrje.

Arsyetimi i vendimit të hapjes së hetimit të përgjithshëm nga ana e Autoritetit të Konkurrencës, të lë të kuptosh se, dyshimi kryesor i Autoritetit është vendosja e çmimeve të padrejta³ për “produktet” bankare, duke pasur parasysh fitimin relativisht të lartë.

Në radhë të parë duhet theksuar se është e nevojshme të provohet që operatorë të caktuar të tregut kanë pozitë dominuese, e cila mund të jetë individuale, por edhe kolektive. Provimi i pozitës dominuese individuale duket se është tejet i vështirë, duke pasur parasysh ndryshimet në pjesët e tregut të bankave më të mëdha me një konkurrencë të fortë midis tyre, apo faktorë të tjerë, që përcaktojnë këtë pozitë. Nga ana tjetër, të provosh një pozitë dominuese kolektive është tepër problematike, si në teori ashtu edhe në praktikë. Kjo pozitë nuk mund të merret e mirëqenë nga

Autoriteti i Konkurrencës, pasi kërkohet që të provohet mungesa e konkurrencës dhe një sjellje uniforme e shoqërive tregtare.

Në rast se do të provohej pozita dominuese, atëherë Autoriteti i Konkurrencës duhet të provojë abuzimin me këtë pozitë, në formën çmimeve të padrejta, të cilat kanë çuar në një fitim të lartë. Kjo, pasi thjesht fitimi i lartë nuk mjafton për të provuar një sjellje anti-konkurrese! Faktikisht, në rastin e tregut bankar, fitimet e larta mund të kenë ardhur për një sërë arsyesh, të



Çdo bankë duhet të ketë mekanizmat e veta efektive të menaxhimit të korporatës, për të siguruar një përputhshmëri të veprimtarisë së saj me ligjin për mbrojtjen e konkurrencës, ashtu siç bëjnë p.sh.: me kuadrin ligjor fiskal, apo rregullator, për bankat e nivelit të dytë.



lidhura me këtë treg specifik, si p.sh.: ulja e nivelit të huave me probleme, shitja e pasurive të paluajtshme të vendosura si kolateral, etj. Për më tepër, rritja e fitimit mund të ketë ardhur edhe si rezultat i nevojës për të përmirësuar treguesit financiarë të viteve të mëparshëm, ku huat me probleme arritën nivele shumë të larta, e për rrjedhojë, edhe provizionet e bankave ndikuan ndjeshëm në uljen e fitimeve të tyre. Gjithashtu, edhe ulja e normës së interesit nga Banka e Shqipërisë ka ndikuar në këtë drejtim.

Për të provuar nëse çmimet e vendosura nga një operator janë të pandershme mbetet, gjithashtu, një detyrë dhe sipërmarrje jo e lehtë për një autoritet konkurrence, veçanërisht kjo në një treg të tillë, si ai bankar. Jurisprudenca e Gjykatës Europiane të Drejtësisë ka theksuar se, marzhi i lartë ndërmjet kostos dhe fitimit nuk mjafton

për të përcaktuar çmimin si të padrejtë. Vetëm në qoftë se ky fitim ka ardhur si shkak i mungesës së konkurrencës, atëherë mund të flitet për çmime të padrejta.

Çfarë duhet të bëjnë operatorët në këto raste?

Këto hetime të përgjithshme janë të dobishme edhe për vetë operatorët e tregut (në rastin tonë bankat tregtare), për shkak të panoramës që ato japin për nivelin e konkurrueshmërisë në treg. Në këtë mënyrë, operatorët duhet të jenë bashkëpunues me Autoritetin e Konkurrencës, duke i vënë në dispozicion çdo informacion të kërkuar prej tij. Pa dyshim, Autoriteti i Konkurrencës nuk mund të kërkojë një informacion të panevojshëm për hetimin, apo të kërkojë çdo informacion, dokument, e të dhënë që disponon operatori (të ashtuquajturat “fishing expeditions”). Kjo mund të përbëjë deri edhe abuzim me detyrën nga autoriteti. Gjithsesi, Autoriteti i Konkurrencës mund të kërkojë të dhëna, të cilat përbëjnë sekret tregtar, apo të dhëna konfidenciale. Operatori duhet të përcaktojë qartë se cila pjesë e informacioneve është sekret tregtar, apo e një natyre konfidenciale. Autoriteti i Konkurrencës mund të kërkojë takime, për të diskutuar mbi të dhënat e informacione e nevojshme, por në këtë fazë të hetimit nuk bëhet fjalë për inspektime të mirëfillta, ku inspektorët mund të hyjnë në mjediset e operatorit, të marrin dokumente e të dhëna, informacion të ruajtur në mënyrë elektronike, etj. Megjithatë, vetë operatorët duhet të ushtrojnë kujdes që të parandalojnë sjellje anti-konkurrese nga stafi i tyre. Çdo bankë duhet të ketë mekanizmat e veta efektive të menaxhimit të korporatës, për të siguruar një përputhshmëri të veprimtarisë së saj me ligjin për mbrojtjen e konkurrencës, ashtu siç bëjnë p.sh.: me kuadrin ligjor fiskal, apo rregullator, për bankat e nivelit të dytë. Gjithashtu, konsulenca e ekspertëve të së drejtës së konkurrencës është e domosdoshme dhe kritike në raste të tilla, për të shmangur në kohë shkeljet e së drejtës së konkurrencës.

³ Veçanërisht vendosja, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, e çmimeve të padrejta blerjeje ose shitjeje, ose e kushteve të tjera të padrejta të tregimit.

Edukimi financiar: Një investim thelbësor

S sektori bankar në të gjithë Europën do të festojnë Javën Europiane të Parasë për herë të dytë në muajin mars 2016. Z. Wim Mijs, Drejtori Ekzekutiv i Federatës Europiane të Bankave, EBF, ftoi Shqipërinë për t'iu bashkuar aktivisht nismës dhe e inkurajon atë për zhvillimin e programit të saj të edukimit financiar.

BANKIERI: Pse sektori bankar duhet të investojë vazhdimisht në edukimin financiar?

Të gjithë jemi dëshmitarë që shoqëria po ndryshon; me rritjen e peshës së telefonave celularë dhe veshjeve të firmosura, shihet që të rinjtë po hyjnë gjithnjë e më shumë në borxhe, e në një moshë më të re se më parë. Kjo është arsyeja pse kemi nevojë për programe të edukimit financiar në shkolla. Kjo është thelbësore. Kërkimet akademike tregojnë qartë se, nëse fëmijët mësojnë rreth vlerave dhe koncepteve themelore të parasë dhe interesit, atëherë ka më pak të ngjarë që ata të zhyten në borxhe, në një moshë të mëvonshme. Këtu mund të luajë rol jo vetëm nga shoqëria dhe qeveritë, por edhe sektori privat, përfshirë bankat edhe shkollat, të cilat duhet të bashkohen forcat për kryerjen e edukimit financiar. Për më tepër që, në një moshë të mëvonshme dhe të shtyrë, kërkesat dhe nevojat e njerëzve për pension bëhen më shumë sesa një çështje



nga Z. Wim MIJS
Drejtor Ekzekutiv

FEDERATA EUROPIANE E BANKAVE (EBF-FBE)

e thjeshtë. Njerëzit bëjnë planet e tyre personale lidhur me aspektet financiare, të investimeve dhe kursimeve. Në këto kushte, është e nevojshme që ata të marrin vendime të pjekura dhe të bazuara në informacion, si dhe duhet të kuptojnë se për çfarë bëhet fjalë në këtë drejtim. Pra, edhe në këtë moshë, edukimi financiar është thelbësor. Rrjedhimisht, është thelbësore për të gjithë ne të vijojmë investimin (në edukim financiar) dhe jam shumë i lumtur kur shoh se Shqipëria dhe Shoqata Shqiptare e Bankave kanë investuar tashmë në një program për edukimin financiar.

BANKIERI: Cilat janë mekanizmat dhe teknikat më efikase që përdoren për edukimin financiar?

Në këtë drejtim, nuk ekziston një masë dhe një kut për gjithë. Shumë vende kanë treguar se kanë qenë mjaft efikas, duke përdorur qasje nga më të ndryshmet. Megjithatë, nëse përqendrohemi te audienca e synuar - të rinjtë përmes shkollave dhe të moshuarit përmes mekanizmave të tjerë - vërehet se ka shumë dobi puna përmes shkollave. Shihet qartë se mësuesi është çelësi, së bashku me prindërit. Hapi i parë në procesin e edukimit financiar kalon gjithmonë

përmes prindërve dhe shkollat duhet të mbështeten. Kjo mund të realizohet duke zhvilluar në mënyrë krijuese, së bashku me ta, programet e edukimit financiar, që mund të përdoren në lëndët e matematikës, analizës matematike, ose të ekonomisë. Përveç kësaj, ai mund të kryhet edhe nëpërmjet organizimit të një vizite në klasë nga një bankier, i cili mund të shpjegojë aspektet bazë të normës së interesit dhe kursimeve. Pra, metoda të ndryshme e të shumta që mund të përdoren; ka më shumë se një rrugë që të çon drejt Romës. Brenda komunitetit të Federatës Europiane të Bankave ka shumë praktika të mirënjohura, të zbatuara me kohë. Në grupet tona ne ndajmë praktikatat më të mira dhe presim që t'i ndajmë ato me bashkëpunëtorët tanë, përfshi Shqipërinë. Ne nuk mund të përcaktojmë se cila mund të jetë praktika më e mirë për vendin tuaj, por së bashku mund të gjejmë diçka që mund të jetë efikase për ju.

BANKIERI: Cilat janë vështirësitë kryesore në procesin e edukimit financiar, veçanërisht në vendet në zhvillim?

Vështirësia e parë qëndron në faktin se, ai shihet jo rrallë herë ose si një instrument konkurrues mes bankave,

ose si një arsye për të ulur standardet e mbrojtjes së konsumatorit. Që të dyja këto nuk janë të vërteta. Në edukimin të gjithë kanë një rol për të luajtur, si qeveria, ashtu dhe sektori privat. Nuk ka konkurrencë në këtë fushë; të gjithë kemi përgjegjësi sociale për ta realizuar atë. Financimi dhe paratë janë një tjetër sfidë. Natyrisht, mënyra më e mirë për ta realizuar atë është krijimi i një platforme që përfshin Bankën Qendrore, Ministrinë e Financave, bankat kryesore, Shoqatën e Bankave, e ndoshta dhe Ministrinë e Arsimit. Shqipërisë i nevojitet një platformë e zgjeruar aktorë publik dhe privat, të cilët bashkohen për të zhvilluar këto instrumente, ndërkohë që këto instrumente kërkojnë financim. Ajo çka nevojitet është një buxhet i përcaktuar për edukimin financiar. Një gjë duhet të jetë shumë e qartë që, sistemi arsimor është zakonisht në nevojë për para'. Ky sistem duhet ndihmuar që ai të zhvillojë programet për edukimin financiar. Një tjetër pengesë, që bie disa herë në sy, është mosbesimi midis sektorit publik dhe atij privat, siç është vënë re në disa prej vendeve të Bashkimit Europian. Përsëri, edhe këtu e vetmja mënyrë për të kapërcyer këtë vështirësi është që të fillojë procesi. Procesi duhet të fillojë nga gjërat e vogla, duke krijuar një bërthamë, e më tej, do shihni që çdo vit programi do të rritet përherë e më shumë dhe do të bëhet më interesant për shumë më shumë njerëz.

BANKIERI: Si mund të ndihmohet dhe mbështetet edukimi financiar nga akademia?

Pjesa dërrmuese e asaj çka bëjmë bazohet në kërkime akademike. Kjo është mënyra e vetme për të jetësuar masat që do të formojnë bazat për një program funksional. Në këtë kuadër, shumë e njohur është profesoresha italo-amerikane zj. Annamaria Lussardi, që ka kryer shumë studime mbi njohuritë financiare, pranë Qendrës së Ekselencës për Njohuri Financiare Globale në Uashington¹. Këto studime kanë luajtur një rol kyç në drejtim të zhvillimit të një programi funksional edukimi financiar, por kjo nuk është e vetmja. Zj. Flore-Anne

Messy e Organizatës së Bashkëpunimit dhe Zhvillimit Ekonomik, OECD², ka grumbulluar për shumë vite të dhëna rreth edukimit njohurive financiare, jo vetëm në Europë, por në gjithë botën. Në bazë të këtyre të dhënave mund të shihen prijet, jo vetëm të njohurive financiare; ato tregojnë se ku mund të jeni efektiv dhe se çfarë mund të jetë efikase për ju. Shifrat dhe faktet janë thelbësore, jo vetëm për të zhvilluar projektet, por edhe për të demonstruar se çfarë funksionon dhe çfarë jo, si dhe shërbejnë si nxitësa për zhvillimin e programeve të ardhshme.

BANKIERI: Si mund të mësojë Shqipëria nga Europa, në aspektin e edukimit financiar?

Të jem i sigurtë, kjo nuk ka të bëjë me të mësuarit; ka të bëjë me pasionin. Nga diku duhet filluar. Shqipëria ka treguar se është e interesuar dhe se ka një program të mirë. Ne jemi këtu për t'ju ndihmuar. Këtu mund të vijmë në ndihmë praktikave dhe përvojat më të mira, nga komuniteti i EBF-së. Juve e dini më mirë atë çka është efikase për vendin tuaj. Gjithashtu, mund të përzgjidhen praktikave të vendeve të tjera të rritit tonë, e të diskutohen me to se çfarë mund të përdoret në rastin e Shqipërisë. Unë e ftoj Shqipërinë t'i bashkohet aktivisht grupit tonë të punës për edukimin financiar, me qëllim që të jetë sa më afër me shkëmbimin e praktikave më të mira. Gjithmonë fillohet me vëzhgimin e rëndësisë së diçkaje, si dhe me përgjegjësinë tonë sociale. Ajo që shpresoj të arrihet me Javën Europiane të Parasë, duke filluar në 14 mars 2016, është që të mund të japim frymëzim. Frymëzim jo vetëm për të filluar diçka gjatë asaj jave, por për fillimin e një programi që vijon gjatë gjithë vitit, e që përsëritet sërish, vit pas viti. Suksesi i EBF-së në edukimin financiar qëndron jo në atë që ne bëjmë si federatë, por ai vjen nga nismat kombëtare të edukimit financiar të anëtarëve tanë, secila prej tyre aktive në kontekstin e vet kombëtar. EBF është thjesht një platformë për shkëmbimin e përvojave dhe për të mësuar nga njëri-tjetri. Kjo platformë

është e hapur dhe për anëtarët e asociuar, si Shqipëria.

BANKIERI: A ka EBF-një program ndërkufitar për anëtarët e asociuar të saj?

Ajo që mësoam nga Java e parë Europiane e Parasë në 2015 ishte prania e një fuqie të madhe të përbashkët, për të grumbulluar të gjithë veprimtaritë e anëtarëve tanë, për të punuar dhe shkëmbyer praktikave më të mira. Java e parë Europiane e Parasë na dha të gjithëve energji të jashtëzakonshme në Europë, madje dhe përtej saj. Sigurisht, për 2016-ën jemi më shumë ambicioz, kështu që në takimin tonë me anëtarët e asociuar në Bruksel, në dhjetor, diskutuam rreth atij që ne e quajmë "program ndërkufitar" për anëtarët e asociuar, ku këta të fundit kanë mundësi të prekin dhe shfrytëzojnë këtë energji dhe fuqi të përbashkët, jo vetëm të anëtarëve të EBF-së, por edhe atë të anëtarëve të asociuar. Ne shpresojmë që t'iu vijë juve në ndihmë jo vetëm juve, por që Java Europiane e Parasë të arrijë deri në vendin tuaj, te qeveria juaj dhe te qytetarët tuaj.

BANKIERI: Çfarë mund të bëjë Shqipëria gjatë Javës Europiane të Parasë?

Kemi vetëm një Javë Europiane të Parasë. Më lejoni ta përsëris edhe një herë se jeni më se të ftuar për të marrë pjesë në të. Ne mund t'iu ndihmojmë me materiale, si me çdo gjë tjetër, që mund të keni nevojë. Shpresojmë që ju të mund ta filloni procesin. Siç thashë, nuk duhet të filloni me gjëra të mëdha. Zakonisht fillohet me një bërthamë gjërash. Ndoshta mund të mbani disa leksione rreth edukimit financiar në një numër të vogël shkollash, ose ndonjë prezantim në Ministrinë e Financave apo Ministrinë e Arsimit. Përndryshe, mund të organizoni një seminar në shoqatën tuaj. Kjo bërthamë e vogël lind aty ku fillon dhe frymëzimi. Kjo është baza nga e cila nis zhvillimi i mëtejshëm i saj. Për ne është një nder dhe kënaqësi e madhe të ftojme Shqipërinë të marrë pjesë aktivisht në Javën Europiane të Parasë, për vitin 2016!

¹ Global Financial Literacy Excellence Centre, Washington DC: <http://gflec.org/>.

² OECD's International Network for Financial Education: <http://www.oecd.org/finance/financial-education/>.



nga Znj. Suela TOTOKOÇI

Drejtoresh e Departamentit të Financës dhe Tregut të Kapitaleve
BANKA INTESA SANPAOLO ALBANIA

Qeveria shqiptare përmbylli me sukses në nëntor të 2015-ës emetimin e Eurobond-it, duke siguruar jo vetëm shumë për shlyerjen e atij ekzistues, por dhe grumbullimin e fondeve të reja. Nëse marrim në konsideratë peshën e Eurobondit të qeverisë shqiptare, përkatësisht rreth 3% e PBB-së në vitin 2014, riemetimi i tij së fundi pritej të ndikonte ndjeshëm portofolin e borxhit dhe strategjinë e qeverisë për menaxhimin e tij. Si rezultat, Ministria e Financave nisi punën që në fillim të vitit 2015, duke kontaktuar dhe diskutuar me ndërmjetës financiarë ndërkombëtarë të ndryshëm, prej të cilëve më pas u përzgjodhën dy: Deutsche Bank dhe JP Morgan Chase, të cilët do të udhëhiqnin procesin e emetimit të Eurobondit të ri.

Në këtë mënyrë qeveria synonte të përfitonte në përgjithësi nga kushtet

EUROBOND-i i qeverisë shqiptare: Një riemetim i suksesshëm



Qeveria emetoi me sukses Eurobond-in e ri, duke rritur vlerën nominale dhe duke ulur ndjeshëm kostot, krahasuar e Eurobond-in që u maturua. Ky ankand konsiderohet i suksesshëm edhe për faktin që libri i urdhrave arriti shifrën prej 750 milionë euro, nga të cilat u pranuan 450 milionë e me një normë kuponit prej 5.75%, ndërkohë që çmimi fillestar i pritshëm (IPT) ishte 6%.



e favorshme në tregjet financiare ndërkombëtare, gjatë gjysmës së parë të vitit 2015, e në veçanti nga normat e ulëta të interesit, që ofroheshin për letrat me vlerë në euro dhe dollarë amerikanë dhe të reduktonte trysninë e investuesve, duke emetuar Eurobond-in e ri para datës së tij të maturimit.

Përveç emetimit të Eurobond-it në tregjet financiare europiane, qeveria vlerësoi edhe mundësinë e hyrjes në tregjet financiare amerikane, meqënëse investuesit amerikanë ishin më të gatshëm të ndërmerrnin rrezik më të lartë, ndërkohë që zhvillimet më të fundit në eurozonë i kishin bërë investuesit europianë më konservatorë e të kujdesshëm.

Nga ana tjetër, trysnia ndaj qeverisë u lehtësua ndjeshëm nga marrja e një huaje të re nga Deutsche Bank prej 250 milionë euro, me kohëzgjatje 10 vjet dhe marzh interesi 1.3% mbi normën referencë, me një garanci 200 milionë euro të Bankës Botërore. Kjo hua afatgjatë, me kushte shumë të favorshme, e ndihmoi qeverinë që të vlerësonte kushtet aktuale të tregut dhe shërbeu si tregues krahasues për riemetimin e Eurobond-it, edhe pse si rreziku dhe afati i maturimit të këtyre dy

instrumenteve ishin të ndryshëm.

Në qershor, pavarësisht angazhimeve dhe faktit që roadshow ishte duke nisur, ndryshimet në tregjet financiare europiane, si rrjedhojë e rishfaqjes së krizës në Greqi, e detyruan qeverinë shqiptare ta shtynte emetimin e



Trysnia ndaj qeverisë u lehtësua ndjeshëm nga marrja e një huaje të re nga Deutsche Bank prej 250 milionë euro, me kohëzgjatje 10 vjet dhe marzh interesi 1.3% mbi normën referencë, me një garanci 200 milionë euro të Bankës Botërore. Kjo e ndihmoi qeverinë që të vlerësonte kushtet aktuale të tregut dhe shërbeu si tregues krahasues për riemetimin e Eurobond-it, edhe pse si rreziku dhe afati i maturimit të këtyre dy instrumenteve ishin të ndryshëm.



CBA

CREDIT BANK OF ALBANIA
BANKA E KREDITIT TE SHQIPERISE

OFERTAT MË TË MIRA DHE KONKURUESE
NË TREGUN BANKAR!



CBA JU OFRON:

Depozita, llogari rrjedhëse dhe me afat, transferta parash, garanci bankare, shkëmbime dhe të gjitha shërbimet tradicionale bankare.

Adresa: Rr. "Perlat Rexhepi",
Ndërtesa Administrative " AL-KHARAFI
(pranë Fuktetit Juridik)
Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 42 272168/66; Fax +355 42 272162
E-mail: creditbkalb@icc-al.org
creditcba@icc-al.org

Sheraton Tirana Hotel
Shopping Plaza
Tel: +355 42 2255372/388/368/346
Fax: +355 42 255340

Hotel "Butrinti" Sarandë
Tel: +355 85 225405

Eurobond-it të ri. Gjithsesi, kjo nuk i solli asnjë problem qeverisë, sepse maturimi i Eurobond-it ekzistues ishte në nëntor 2015 dhe qeveria nuk kishte asnjë nevojë urgjente për likuiditet, falë huas së re nga Deutsche Bank dhe huamarrjes së brendshme.

Afrimi i datës së maturimit e riktheu vëmendjen e investuesve të emetimi i Eurobond-it të ri, në një kohë kur investuesit ishin të vetëdijshëm se qeveria kishte likuiditet të mjaftueshëm, për të shlyer Eurobond-in ekzistues, pa pasur nevojë ta rriemonte atë. Si rezultat, qeveria ishte në kushte shumë komode, duke synuar emetimin e Eurobond-it me kushte tregu sa më të favorshme. Kjo ishte ajo çka ndodhi më 5 nëntor 2015, një ditë pas shlyerjes së plotë të Eurobond-it ekzistues, sipas kushteve të përcaktuara.

Qeveria emetoi me sukses Eurobond-in e ri, duke rritur vlerën nominale dhe duke ulur ndjeshëm kostot, krahasuar e Eurobond-in që u maturua. Ky ankand konsiderohet i suksesshëm edhe për faktin që libri i urdhrave arriti shifrën prej 750 milionë euro, nga të cilat u pranuan 450 milionë e me një normë kupon prej 5.75%, ndërkohë që çmimi fillestar i pritshëm (IPT) ishte 6%.

Për të vlerësuar nëse norma e kuponit 5.75% ishte më e mira që mund të ofronte tregu për një letër me vlerë të tillë, duhet të bëjmë një krahasim të marzhit të emetimit prej 592.4 pikë përqindjeje kundrejt normës referencë, për Eurobond-in e ri shqiptar, me marzhin 471.02 pikë përqindjeje kundrejt normës referencë të Eurobond-it më të fundit të qeverisë së Malit të Zi, me maturim në vitin 2019. Nëse marrim në konsideratë edhe vlerësimin më të mirë të Malit të Zi (B+) dhe jetëgjatësinë e mbetur më të shkurtër të këtij instrumenti (4 vjet), gjykohet se Eurobond-i shqiptar ka marrë një çmim të drejtë tregu, pavarësisht faktit që u emetua gjatë një periudhe me luhajtje të konsiderueshme në tregjet europiane, për vende si Shqipëria. Kjo u konfirmua edhe më tej, kur qeveria e Republikës së Maqedonisë emetoi një Eurobond 5 vjeçar në 1 dhjetor 2015 me normë



kuponi 4.875% dhe vlerë nominale 270 milionë euro. Po të kemi parasysh vlerësimin më të lartë që S&P i ka bërë Maqedonisë (BB-) kundrejt Shqipërisë (B), si dhe shumën më të vogël në emetim, besohet se qeverisë shqiptare i janë ofruar kushtet më të favorshme që tregjet ndërkombëtare mund t'i ofronin në vendeve me vlerësim të ulët si Shqipëria.

Një tjetër faktor që ka pasur ndikim në këto kushte ka qenë dhe fakti që Shqipëria është klasifikuar për perspektivën nga agjencitë e vlerësimit si “E qëndrueshme” (Moody’s) ose “Pozitive” (S&P), pjesërisht edhe falë



Falë ndryshimeve më të fundit të rregullores së Bankës së Shqipërisë “Mbi ekspozimet e mëdha”, ku u ul përqindja e peshimit të aktiveve për letrat me vlerë të qeverisë shqiptare të emetuara në monedhë të huaj, nga 100% në 50%, bankat vendase mundeshin tani të dyfishonin portofolin e tyre fillestar në monedhë të huaj, për më tepër që, ky instrument konsiderohet si shumë fitimprurës për bankat shqiptare, pasi paguan një kupon 5.75%, në një kohë kur normat e tregut të parasë janë negative dhe normat e kthimit të obligacioneve janë në pikën e tyre më të ulët historike.

reformave të ndërmarra gjatë viteve të fundit dhe marrëveshjeve me FMN-në dhe BB-në.

Bankat shqiptare kanë pasur në portofolet e tyre Eurobond-in që maturohej në nëntor të 2015-ës dhe ishin të interesuara t'i rinovonin këto investime. Meqënëse ky instrument paguan një kupon 5.75% për euron, në një kohë kur normat e tregut të parasë janë negative dhe normat e kthimit të obligacioneve janë në pikën e tyre më të ulët historike, ky instrument konsiderohet si shumë fitimprurës për bankat shqiptare. Për më tepër, falë ndryshimeve më të fundit të rregullores së Bankës së Shqipërisë “Mbi ekspozimet e mëdha”, ku u ul përqindja e peshimit të aktiveve për letrat me vlerë të qeverisë shqiptare të emetuara në monedhë të huaj, nga 100% në 50%, bankat vendase mundeshin tani të dyfishonin portofolin e tyre fillestar në monedhë të huaj.

Bankat shqiptare janë shumë të ekspozuara në letrat me vlerë të qeverisë shqiptare në monedhë vendase e ky ekspozim nuk është subjekt i kufizimeve nga rregulloret e Bankës së Shqipërisë dhe konsiderohet si investime pa rrezik. Ndërkohë, siç u përmend edhe më lart, letrat me vlerë të qeverisë shqiptare të emetuara në monedhë të huaj kanë një përqindje peshimi me rrezik prej 50%, duke u vlerësuar më të rrezikshme se letrat me vlerë në Lek. Pavarësisht gjithë kësaj, për aq kohë sa ky ekspozim do të monitorohet me kujdes, nuk besohet se ai përbën ndonjë rrezik të lartë për bankat që operojnë në Shqipëri.





nga **Z. Alban BURAZERI**

Drejtor i Njësisë së Operacioneve dhe
Teknologjisë së Informacionit
ALPHA BANK ALBANIA

Termi "Të dhëna masive" (BIG DATA) është relativisht i ri dhe si për çdo term të ri, mund të jepen përkufizime të ndryshme. Në burimet e hapura, të dhënat masive përkufizohen si grupime të dhënash shumë të mëdha ose komplekse, të strukturuar ose jo dhe aplikacionet tradicionale të përpunimit të të dhënave konsiderohen si të pamjaftueshme për përpunimin e tyre. Koncepti mori shtysë në fillim të viteve 2000, kur analistët kryesorë të industrisë së teknologjisë së informacionit (TI), artikuluan përkufizimin e të dhënave masive si tri V-të (*Volume/Velocity/Variety*):

Vëllimi - Organizatat mbledhin të dhëna nga burime të ndryshme, përfshirë këtu dhe transaksionet e bizneseve, mediat sociale dhe informacione të marra që nga sensorët e deri te robotët e mble-

Të dhënat masive (Big Data)

dhe sistemi bankar shqiptar



Një tjetër sfidë për bankat në Shqipëri është përballja me strukturat e papërshtatshme organizative që merren me të dhënat masive. Evidentohet një mungesë e përpjekjeve të përbashkëta për të agreguar analizat përgjatë gjithë sistemit bankar dhe për ta ngritur në një nivel më lart, vendim-marrjen e bazuar në dije.



dhjes së të dhënave.

Shpejtësia - Transmetimi i të dhënave me një shpejtësi shumë të madhe e që trajtohen në kohën e duhur.

Larmia - Të dhënat vijnë në të gjitha llojet e formateve, nga të dhënat e strukturuar numerike në bazat tradicionale të të dhënave, deri te dokumentet e pastrukturuar në fomë teksti, mail-i, video, audio, të dhëna specifike për aksionet dhe transaksionet financiare. Në ditët e sotme, është më se e zakonshme që të merren parasysh edhe dy dimensionet e tjera, lidhur me të dhënat masive:

Ndryshueshmëria - Përveç rritjes së shpejtësisë dhe larmisë së të dhënave, rrjedhat e të dhënave mund të mos jetë fare në përputhje me pikun periodik të përdorimit të tyre.

Kompleksiteti - Të dhënat e sotme vijnë nga burime të shumta, të cilat e bëjnë të vështirë lidhjen, ballafaqimin, pastrimin dhe transformimin e të dhënave, përgjatë gjithë sistemeve. Burimet për të dhënat masive në përgjithësi përfshihen në një nga tre kategoritë e mëposhtme:

Rrjedhje të dhënash - Përfshin të dhënat që mbërrijnë në sistemet e TI-së e

nga pajisje të lidhura në rrjete. Ato mund të analizohen sapo mbërrijnë dhe mbi to mund të merren vendime se cilat prej tyre duhen mbajtur ose kërkojnë analiza të mëtejshme.

Të dhënat nga mediat sociale - Përbëjnë një grup informacioni gjithnjë e më tërheqës, veçanërisht për funksionet e marketingut, shitjeve dhe ato mbështetëse. Shpesh këto të dhëna janë jo të strukturuar ose gjysmë të strukturuar, kështu që përdorimi i dhe analizimi i tyre paraqet një sfidë të veçantë.

Të dhëna nga burime publikisht të disponueshme - Një sasi tejet e madhe e të dhënave janë të disponueshme përmes burimeve të hapura të të dhënave, si p.sh.: Portali i të Dhënave të Hapura të Bashkimit Europian.

Pas identifikimit të të gjithë burimeve të mundshme për të dhënat, duhet të kihen parasysh vendimet e nevojshme që duhen marrë, pasi fillohet shfrytëzimi i të dhënave, të cilat përfshijnë:

Si të ruben dhe menaxhohen të dhënat - Nëse ruajtja e të dhënave ishte problem vite më parë, tashmë ekzistojnë alternativa me kosto të ulët për ruajtjen e të dhënave, nëse kjo është strategjia më e

mirë për biznesin në fjalë.

Sa prej të dhënave duhen analizuar

- Disa organizata nuk përjashtojnë asnjë të dhënë prej analizave të tyre, të tilla si: rrjetet kompjuterike (*grid computing*), ose analizat e të dhënave të procesuara dhe menaxhuara në memorie (*in-memory analytics*). Një tjetër mënyrë është përcaktimi paraprak i të dhënave të vlefshme, përpara analizim të mëtejshëm të tyre.

Si të përdoren gjërat e reja që zbulohen - Sa më shumë njohuri fitohen, aq më i madh është besimi në marrjen e vendimeve të biznesit. Ekzistenca e një strategjie funksionale në praktikë është diçka e mençur, në momentin që disponohet një sasi e madhe informacioni.

Hapi përfundimtar i shfrytëzimit të të dhënave masive për qëllime biznesi është kërkimi i teknologjive që ndihmojnë në gjenerimin e këtyre të dhënave masive, apo në analizimin e tyre. Këtu duhen marrë parasysh: (i) Kapacitete të ruajtjes së tyre në vëllime të mëdha dhe me kosto të ulët; (ii) Procesorë më të shpejtë, (iii) Burime të hapura të dhënash dhe platforma të mëdha të të dhënave; (iv) Përpunime paralele, clustering, MPP, virtualizim, mjedise me rrjetesh të mëdha kompjuterike (*grid computing environment*), lidhje në rrjet me shpejtësi dhe transferueshmëri të lartë; dhe (v) Përdorimi i teknologjisë “Cloud” dhe përshtatje të burimeve të tjera fleksibël.

Të dhënat masive ndikojnë në organizatat që operojnë praktikisht në çdo industri, përfshirë këtu: bankungun, edukimin, administratën shtetërore, shëndetësinë, prodhimin, shitjet me pakicë, etj. Të përballur me sasi të jashtëzakonshme rrjedhash të dhënash nga burime të panumërta, bankat duhet të gjejnë mënyra të reja, për të menaxhuar të dhënat masive. Është e rëndësishme të kuptohen klientët dhe të rritet kënaqësia e tyre, po është po aq e rëndësishme edhe minimizimi i rrezikut dhe mashtrimeve, duke siguruar njëkohësisht dhe përputhshmërinë ligjore. Rëndësia e të dhënave masive nuk qëndron në faktin se sa shumë të dhëna disponohen, por se çfarë bëhet me to. Të dhënat

mund të merren nga cilido burim dhe të analizohen me qëllim gjetjen e përgjigjeve që mundësojnë: 1) reduktim të kostove, 2) reduktimin e kohës, 3) zhvillimin e produkteve të reja dhe dhënien e ofertave optimale, si dhe 4) një vendim-marrje të zgjuar. Studimet tregojnë se, institucionet financiare besojnë se analizimi i të dhënave masive ofron një avantazh konkurrues, e për më tepër, nismat e suksesshme për të dhënat masive do të përcaktojnë dhe fituesit e së ardhmes. Ende pak banka kanë eksperiencë të prekshme me përdorimin në praktikë të të dhënave masive, ndërkohë që shumica e bankave janë ende të fokusuar në projekte pilot dhe eksperimente. Pse bankat nuk janë në gjendje të shfrytëzojnë të dhënat masive? Studimet tregojnë se organizimi i tyre i fragmentuar është pengesë për sukses me të dhënat masive. Mungesa e talenteve analizues, kostoja e lartë e menaxhimit të të dhënave, si dhe mungesa e fokusit strategjik mbi të dhënat masive janë të tjera pengesa. Së fundi, shqetësimet rreth privatësisë, janë gjithashtu një problematikë e rëndësishme. Por si mund të krijohet bankat një vlerë më të madhe nga të dhënat masive? Në këtë drejtim ekzistojnë dy fusha të gjera:

1. Analizimi i klientëve, që përfshin procesin e çmuarjes, analizat marketing, të shitjeve dhe të kanaleve të shpërndarjes.

2. Menaxhimi i rrezikut, që ka të bëjë me raportimin financiar dhe analizën e mashtrimeve.

Analizimi i të dhënave të klientëve është një fushë me prioritet relativisht të ulët për bankat. Shumë banka nuk përqendrojnë energji të konsiderueshme në përdorimin e analizave, për të zgjeruar përvojën pozitive të klientit. Vrojtimet tregojnë se, menaxhimi i rrezikut ka qenë një fushë me prioritet të lartë për shumicën e bankave, kryesisht si rrjedhojë e përputhshmërisë me kërkesat ligjore, ndërkohë që analizimi i klientëve është lënë thuajse fare pas dore. Bankat mund të maksimizojnë vlerën e të dhënave të klientëve të tyre, duke përdorur përparësitë që krijon analizimi i të dhënave masive përgjatë tri fushave kryesore të ruajtjes së klientelës, rritjes

së pjesës së tregut dhe shpenzimeve të tyre kundrejt produkteve të bankës, nëpërmjet: (1) Tërheqjes së klientëve, me anë të përmirësimit të vlerësimit të rrezikut të besueshmërisë dhe maksimizimit të potencialit të interesit të klientëve të mundshëm; (2) Ruajtjes së klientëve, duke kufizuar largimin dhe përmirësuar kënaqësinë e tyre; (3) Rritjes së buxhetit të shpenzimeve të klientëve për produktet e bankës, duke rritur eficiencën e programeve marketing dhe rritjes së shitjeve nëpërmjet analizave parashikuese.

Nismat për përdorimin e të dhënave masive zakonisht kërkojnë dhe konsumojnë shumë kohë dhe burime. Me qëllim zbatimin e lehtë të tyre, bankat duhet të ndjekin një qasje me tre hapa, që fillon me vlerësimin e kapaciteteve analizuese ekzistuese, që ndiqet nga lançimi i projekteve pilot, të cilët zgjerohen më tej në programe në shkallë të gjerë, përgjatë gjithë organizatës. Alpha Bank Albania po përdor të dhënat masive në dy fusha kryesore: Menaxhimin e Marrëdhënieve me Klientët (CRM) dhe zbulimin e mashtrimeve. Projekti CRM është pilotuar me sukses dhe po jetësohet në shkallë të gjerë. Projekti zbulimit të mashtrimeve, që mund të shihet edhe si një analizë e shkeljeve ligjore në përgjithësi, është në një fazë më të përparuar dhe aktualisht po zgjerohet dhe modifikohet. Kur bëhet fjalë për të dhëna masive në Shqipëri, vështirësia qëndron në mungesën e burimeve publikisht të disponueshme. Duhet përmendur dhe mungesa e një shkëmbimi periodik, zyrtar dhe të organizuar të informacionit midis pjesëmarrësve në industrinë bankare. Një tjetër sfidë për bankat në Shqipëri është përballja me strukturat e papërshtatshme organizative që merren me të dhënat masive. Analizimi i të dhënave si funksion zakonisht shihet edhe pjesë e MSI-së, edhe pjesë e menaxhimit të rrezikut, edhe si pjesë e biznesit. Evidentohet një mungesë e përpjekjeve të përbashkëta për të agreguar analizat përgjatë gjithë sistemit bankar dhe për ta ngritur në një nivel më lart, vendim-marrjen e bazuar në dije.

Tregu shqiptar i produkteve dhe pagesave elektronike (karta, ATM, etj.) filloi të funksionojë rreth viteve 2002-2003 nga disa banka, nëpërmjet kartave proprietare, të përdorura brenda një rrjeti të vogël bankomatësh. Rritja e këtij tregu pësoi një zhvillim rrënjësor gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, sidomos gjatë viteve 2005 – 2006. Institucionet shtetërore, përfshirë dhe Bankën e Shqipërisë, kanë vlerësuar gjithnjë kontributin e teknologjisë dhe novacioneve në shërbimet financiare si mbështetje për arritjen e objektivave strategjike të tyre, për përfshirjen financiare të publikut dhe reduktimin e përdorimit të parasë fizike në ekonomi. Këto objektiva i shërbejnë në mënyrë të qenësishme, si transmetimit të politikës monetare, ashtu dhe ruajtjes së stabilitetit financiar. Eksperienca ndërkombëtare ka treguar se përdorimi i risive në sektorin bankar dhe sistemin financiar kontribuon në reduktimin e kostove sociale në ekonomi, përafërsisht nga 1- 2% të PPB-se. Kjo shifër, në rastin e Shqipërisë, mund të jetë edhe më e lartë, pasi përdorimi i parasë fizike në ekonomi mbetet ende në nivele relativisht të larta.

Krahasuar me vendet e rajonit rritja e përdorimit të kartave shënon një prirje të pranueshme, duke marrë parasysh popullsinë aktive në Shqipëri, që raportohet të jetë rreth 1.1 milionë banorë, në një treg të brendshëm me rreth 900,000 karta, të lëshuara nëpërmjet sistemit bankar, duke zënë një peshë specifike prej 82% karta të lëshuara për popullsi aktive. Nisur nga kjo, mund të thuhet që ekzistojnë një sërë segmentesh dhe mundësish, për t'i dhënë një shtysë pozitive këtij biznesi. Hapësirat për përmirësim dhe ngushtim të hendekut midis tregut shqiptar dhe tregjeve të vendeve të zhvilluara, por deri diku dhe atyre të vendeve të rajonit, janë ende të mëdha dhe përbëjnë sfidën tonë të përbashkët për të ardhmen. Për më tepër,



Zj. Irida HUTA

Drejtoreshë për Zhvillimin e Biznesit dhe Shitjeve, PAY LINK



Z. Dritan MOLLANJË

Drejtor i Teknologjisë PAY LINK

Sistemet e pagesave elektronike në Shqipëri

Projekte dhe risi për rritjen e efikasitetit



Operatorët e skemave lokale të pagesave elektronike kane si qëllim dhe fokus mbështetjen e sistemit bankar dhe financiar, lidhur me ofrimin e shërbimeve bashkëkohore dhe novatore, me kosto të ulët dhe efikasitet të lartë.

mbetet ende sfidë për sistemin bankar dhe qeverinë minimizimi i qarkullimit të parasë fizike në ekonomi, nëpërmjet projekteve të veçanta të drejtuara si nga qeveria, apo pushteti vendor.


PayLink dhe projektet për pagesat elektronike

Shoqëria PayLink, e angazhuar prej disa vitesh në sistemin shqiptar të pagesave elektronike, synon të ofrojë disa zgjidhje

dhe lehtësi pagesash në Shqipëri, nisur nga fakti që një pjesë e mirë e tyre kryhen jashtë sistemit bankar. Ajo çka synohet nëpërmjet këtyre zgjidhjeve është që edhe Shqipëria t'i përfaqësojë vendeve të rajonit dhe më gjerë, të cilët kanë një zhvillim më pozitiv në këtë drejtim, duke i kanalizuar këto projekte drejt sistemit bankar/financiar dhe synuar në grup klientësh potencial, prej me shumë se 600,000 kartëmbajtësish. Konkretisht,



Rritja e numrit te Kartave - Tregu



PayLink ka marrë nismën të propozojë dhe të japë një zgjidhje teknike dhe mbështetje për dy projekte, pjesë e programit të qeverisë, për t'i shërbyer dhe për të përmbushur detyrimet ndaj qytetarëve, të tilla si: projekti i pensioneve, në kuadër të reformës së pensioneve dhe projekti i transporteve për Bashkinë e Tiranës.

Projekti i Pensioneve

Karta e pensioneve është një produkt i ofruar në tregun shqiptar për një segment të përcaktuar: pensionistët e kualifikuar, sipas udhëzimeve të Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Qëllimi parësor është të krijohen mundësitë që reforma e pensioneve të marrë trajtat dhe format e kërkuara, duke e kanalizuar këtë proces nëpërmjet sistemit bankar, duke edukuar tregun vendas, si dhe formalizuar procesin. Ky projekt do të ofrojë mundësinë e tërheqjes së pensioneve nëpërmjet kartës bankare me funksion financiar. Ky proces do të udhëhiqet nga ISSH-ja, në bashkëpunim me bankat tregtare, si aktorët kryesorë të procesit, duke iu mundësuar zgjidhje teknike dhe operacionale nga PayLink. Ky projekt siguron një sërë përfitimesh për të gjithë aktorët, si:

Pensionistët: Sigurimi i një shpërndarjeje të pensioneve në kushte optimale, pa rradhë pritjeje, qasje në fondet e pensioneve në çdo kohë (24/7/365) si dhe përdorim të gjerë për pagesa, transport urban, pagesa faturash, zbritje çmimesh, apo përfitime të ndryshme nga tregtarët në vend.

ISSH: Ofrimi i një shërbimi të dedikuar dhe bashkëkohor për qytetarët, reduktim i kostove operacionale dhe rritje e efikasitetit të shërbimit, duke pasur mundësinë dhe komoditetin e një rakordimi të menjëhershëm apo online, me një kontroll të veprimeve dhe autentikim me siguri të lartë të transaksioneve, përmes sistemeve të teknologjisë së përparuar.

Bankat: Do të kenë mundësinë e rritjes së përfitueshmërisë, nëpërmjet një produkti dhe segmenti të ri, si dhe mundësi për shitje të kryqezuara, përdorim të produkteve dhe veprimeve me kosto të ulët, me një potencial klientele me mbi 500,000 klientë.

Projekti i Transportit Urban për Bashkinë e Tiranës

Procesi aktual i transporteve është tërësisht manual dhe jo i mirëkontrolluar. Ajo çka PayLink do të synojë të ofrojë lidhet me një zgjidhje të automatizuar teknike, afatgjatë e me kosto të ulët, efikasitet në shërbimet e ofruara dhe përfitueshmeri, si për lëshuesit (bankat), ashtu edhe për mbajtësit e tyre. Zgjidhja e ofruar synon të mundësojë përdorimin e kartave të transportit në infrastrukturën aktuale të bankave, si: POS-e dhe ATM, për t'iu ofruar shërbim qytetarëve, në kuadër të përdorimit të kësaj karte në sistemin e transportit. Duhet të theksohet se, në një pjesë të madhe të vendeve europiane e më gjerë, këto produkte kombinohen me shërbime të tjera, të ofruara nga bashkitë përkatëse, që japin mundësinë e përdorimit të gjerë, kudo

ku bankat kanë vendosur pajisje të pagesave me kartë, duke u quajtur edhe si karta e qytetit, sidomos e kombinuar me funksionalitetin "Contactless" për pagesa me vlera të vogla dhe të menjëhershme/ të shpejta. Në përfundim, vlen të theksohet se, Shqipëria, sikundër dhe vendet e tjera të rajonit e me gjerë, ka një potencial të madh zhvillimi në drejtim të kanalizimit të tregut drejt pagesave elektronike në të gjitha fushat, me përfitime të ndërsjella për të gjithë pjesëmarrësit dhe grupet e interesit, të lidhur me këto skema. Tashmë ka ardhur koha që automatizimi dhe formalizimi i proceseve, lidhur me fushën e shërbimeve konsumatore, të marrë jetë edhe në Shqipëri. Shoqëria PayLink mbetet në dispozicion të sistemit financiar/bankar për të mbështetur çfarëdo nisme, apo propozim, në këtë drejtim.

PayLink në Shqipëri

Qendra Shqiptare e Procesimit PayLink është krijuar si shoqëri anonime në shtator të vitit 2012 dhe liçencuar nga Banka e Shqipërisë më 4 tetor 2013 si Operator Kombëtar për Pagesat me Kartë, duke filluar veprimtarinë në vitin 2014. Ky subjekt i ri në tregun shqiptar ka synim që të jetësojë, zhvillojë dhe mirëmbajë në platformën e ofruar, pagesat elektronike, duke krijuar një sistem të mirëfilltë dhe të plotë në ofrimin e produkteve dhe shërbimeve të tilla në tregun vendas. Kjo realizohet falë mbështetjes, teknologjisë dhe sistemeve të përparuara, mundësuar nga një personel i kualifikuar.

DEPOZITA 5 VJEÇARE

RITËM, PASION, PËRKUSHTIM!
INVESTONI NË DEPOZITË
5 VJEÇARE ME INTERES
DERI NË 4.5% LEKË



CREDINS bank

Ne flasim gjuhën tuaj!



nga Prof. Dr. Adrian CIVICI

President

UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS, UET

Vendimi i fundit unanim i datës 18 dhjetor 2015, i Komitetit të Politikës Monetare të FED-it për rritjen e normës bazë të interesit për dollarin amerikan me 25 pikë, duke kaluar nga intervali 0 - 0.25% në një interval 0.25 - 0.50%, konfirmoi në mënyrë simbolike se kriza financiare globale, e shpërthyer në vitin 2008, mund të konsiderohet si e tejkaluar. Ndryshe nga shumë parashikime e dyshime, kjo rritje e normës bazë të interesit pas një periudhe 10 vjeçare, e para rritje që prej vitit 2006, nuk provokoi asnjë panik në bursat dhe tregjet e tjera financiare. Në 2008-ën filloi ajo që u cilësua si “eksperimenti i FED: politikë monetare akomoduese me kosto minimale të dollarit afër zeros”. Mjaft nga bankat e tjera qendrore në botë bënë të njëjtën gjë. E gjithë bota, thuajse në unanimitet, mendoj se kjo ishte përgjigjia e duhur

Mesazhet dhe efektet e vendimit të FED për rritjen e normës së interesit



Ekspertët e politikave monetare dhe bankierët qendrorë mendojnë se nuk kemi të bëjmë me një vendim që mund të kufizohet brenda SHBA-së, por për një vendim që pritet të ketë efekte ndërkombëtare, duke shkaktuar turbulenca në shumë vende të botës.



ndaj krizës globale financiare. Ky cikël u ndërpre në 18 dhjetor nga vendimi i ri i FED-it për ndryshimin e kahut të politikës monetare drejt rritjes.

Analistët dhe ekspertët e tregjeve financiare vlerësojnë se mesazhet dhe “leksionet” kryesore që mund të nxirren nga një vendim i tillë mund të sintetizohen si më poshtë:

Së pari, mënyrat e komunikimit të bankave qendrore përbëjnë një instrument mjaft eficient, për të kanalizuar pritshmëritë dhe vendim-marrjen e investuesve të ndryshëm. Pas braktisjes surprizë nga ana e NBS-së (Banka Kombëtare Zvicerane), në janar 2015, të kursit dysheme të frangës zvicerane kundrejt euros, i fiksuar që në vitin 2011 në raportet 1 euro = 1.20 franga, në mënyrë “që të shpëruj nga solidarizimi me euro-n kundrejt frikës së një zhvlerësimi të vazhdueshëm të euro-s, që mund të ndikonte negativisht në qëndrueshmërinë e frangës dhe raporteve të saj me dollarin amerikan”; pas mundësisë potenciale të pashfrytëzuar të FED-it për të rritur normën e interesit të dollarit, që në shtator 2015 dhe preferencës së saj për ruajtjen e status quo - së, me gjykimin se:

“ende ekonomia amerikane nuk ishte në nivelet e duhura të rritjes ekonomike dhe punësimit”; e sidomos pas paqartësive të tregjeve financiare pas qëndrimeve të fundit të BQE-së (Banka Qëndrore Europiane) në kuadrin e politikës së saj të “lehtësimit monetar, vendimet e bankave qendrore kryesore dolën në plan të parë,



E parë në një këndvështrim më të gjerë edhe në raport me vendimet e fundit të bankave qendrore në Japoni, Europë, Angli, Rusi, Kinë, etj., vlerësohet se të gjithë po binden se epoka e “parasë së lirë” po merr fund, ku ekonomitë e reja rrezikohen nga destabilizimi, si pasojë e rrezikut të largimit të investimeve dhe investuesve drejt dollarit dhe SHBA-së.



përsa i përket ndikimit në orientimin e tregjeve financiare, kursit të këmbimit dhe bursave. Mungesa e panikut dhe tensioneve në këto tregje pas vendimit të FED-it dëshmon se sa i rëndësishëm

është besimi i investuesve dhe strategjive të tyre monetare e financiare të mesazhi dhe qëndrimet e bankave qendrore.

Së dyti, përmbajtja dhe shpjegimi i qartë e bindës i komunikimit në publik të vendimit të FED-it u shfaq si një element i rëndësishëm garantues, në konfirmimin e faktit se procesi i normalizimit të normës bazë të interesit do të jetë gradual dhe progresiv. Në thelbin e tij evidentohet konsensusi me dëshirën dhe pritshmërinë e tregjeve financiare dhe monetare, që deri në fund të vitit 2016 të ketë dhe disa rritje të tjera të normës bazë të interesit, për ta çuar atë në nivelet 1%. Realizimi në praktikë i këtij skenari në mjediset bankare e financiare përkthehet si mundësi që, “kushtet e huadhënies të vazhdojnë të mbeten akomoduese”, gjë që do krijojë mundësinë e evitimit të shpërthimit të fluskave spekulative, të cilat mund të jenë formuar në disa prej segmenteve të tregjeve financiare, që prej lançimit të programit të lehtësimit sasior në dhjetor 2008. Me këtë lëvizje FED dëshiron të evitohet luhajtjet e çmimeve të obligacioneve të korporatave në sektorët energjetikë e minerarë, që janë veçanërisht më të ndjeshëm ndaj lëvizjeve të tilla.

Së treti, orientimi i ri i normës bazë të interesit i dollarit amerikan pritet të shkaktojë në muajt në vazhdim një seri axhustimesh në politikën monetare të mjaft vendeve të tjera, veçanërisht në grupin e ekonomive të reja, si: Kina, Rusia, Brazili, India, Turqia, Meksika, etj. Mjaft nga bankat qendrore të këtyre vendeve kanë deklaruar se, “në përgjigje të vendimit të fundit të FED-it, ato janë gati të përgjigjen me të njëjtën monedhë”, pra duke filluar një spirale rritje të normës bazë të interesit të monedhave të tyre, me qëllim që të pengojnë largimin e kapitaleve dhe zhvlerësimin e monedhave kombëtare, megjithëse një pjesë e këtyre vendeve janë përballë dilemës nëse duhet të ndjekin linjën e FED-it apo duhet të pranojnë zhvlerësimin e monedhave të tyre, në emër të stimulimit të veprimtarisë ekonomike dhe eksporteve. Megjithëse vendimi i FED-it nuk mund të barazohet me efektin e një paradigme të re monetare për ekonominë botërore,

përsëri ai dëshmon se tashmë ekonomia dhe financat botërore po futen në një cikël të ri ekonomik post-krizë.

Pyetjet që mbizotërojnë në mjediset bankare pas këtij vendimi “të pritshëm të FED-it” janë: pse tani ... cilat janë synimet dhe objektivat kryesore të saj ... cilat janë efektet e pritshme për ekonominë dhe monedhat e tjera, qofshin këto vende të mëdha, të zhvilluara, të



Një përfundim i përgjithshëm, për të cilin duket se ka një konsensus, është fakti se “ky veprim duhet kuptuar si një sinjal serioz se kriza globale financiare e shpërthyer në 2008 duket se ka mbaruar, se rreziqet serioze që kërcënonin tregjet financiare e monetare ndërkombëtare janë zvogëluar ndjeshëm, se fakti që FED-i nuk e mori këtë vendim në muajin tetor, kur dukej më se i arsyeshëm dhe pritej nga të gjithë, tregon se edhe shqetësimet që lidheshin me ekonominë dhe monedhën kineze janë tejkaluar.



vogla apo të varfër ... çfarë reagimesh priten nga bankat qendrore kryesore, etj? Reagimi i parë i përgjithshëm në mjediset bankare dhe financiare ndërkombëtare ishte i tipit: “... më në fund vendosën pas kaq e kaq kohe që linin të kuptohej se do ta merrnin këtë vendim, pas 10 vitesh ulje apo mbajtje konstante të normës bazë të interesit”. Në shpjegimin e Komitetit të Politikës Monetare pohohet se, “rritja e normës bazë të interesit pasqyron besimin e FED-it në procesin e vazhdimin të forcimit të ekonomisë. Rrigjallërimi ekonomik ka bërë progres të dukshëm, megjithëse nuk ka arritur ende në nivelet e duhura ... kërkohen përmirësime thelbësore në

tregun e punës, ndërkohë që inflacioni vazhdon të evoluojë nën objektivat tona afatgjatë. Por, me një ekonomi të qëndrueshme aktuale dhe prirje pozitive për të ardhmen, Komiteti gjykoj që një rritje modeste e objektivit të Fed Funds është e arsyeshme, duke mbajtur në konsideratë, se edhe pas kësaj rritje, politika monetare do vazhdojë të jetë akomoduese”.

FED nënvizon se “nuk duhet mbivlerësuar domethënia e kësaj rritje të parë pas 10 vitesh të normës së interesit”, ndërkohë që shumë ekspertë e shoqërojnë këtë qëndrim të FED-it me pyetjen: “a është kjo lëvizje një mesazh për të ardhmen e politikës monetare amerikane, për të ardhmen e dollarit në teatrin ndërkombëtar të luftës së monedhave dhe përcaktimit të flukseve financiare globale”? Analizat dhe përgjigjet janë mjaft të moderuara.

Një përfundim i përgjithshëm, për të cilin duket se ka një konsensus, është fakti se “ky veprim duhet kuptuar si një sinjal serioz se kriza globale financiare e shpërthyer në 2008 duket se ka mbaruar, se rreziqet serioze që kërcënonin tregjet financiare e monetare ndërkombëtare janë zvogëluar ndjeshëm, se fakti që FED-i nuk e mori këtë vendim në muajin tetor, kur dukej më se i arsyeshëm dhe pritej nga të gjithë, tregon se edhe shqetësimet që lidheshin me ekonominë dhe monedhën kineze janë tejkaluar. Tregjet duket se ishin të përgatitura për këtë lëvizje dhe reagues pozitivisht dhe me qetësi ndaj saj. Meqënëse norma bazë e interesit të dollarit ka një ndikim të drejtpërdrejt mbi normat e interesit të huave që japin bankat tregtare, efektet e para pritet t'i shfaqin bizneset dhe sipërmarjet, të cilat duke parashikuar një rritje të koston së huas në muajt në vazhdim, pritet të rrisin dhe shumëfishojnë investimet e tyre. Ndërkohë që zj. Xhenet Jellen, Kryetarja e FED parashikon që rritja e normës bazë të interesit pritet të shkojë në 1.4% në 2016, 2.5% në 2017 dhe 3.5% në 2018, si efekt kryesor i kësaj rritje pritet të jetë edhe rritja e nivelit të punësimit në SHBA, aq më tepër që në objektivat e FED-it, rritja ekonomike dhe punësimi,

janë po aq të rëndësishëm sa edhe stabiliteti i çmimeve.

A shënon ky vendim “fundin e një politike monetare relaksuese e akomoduese nga ana e FED-it, të ndërmarrë në kuadrin e nevojës për mbështetjen e ekonomisë amerikane dhe stimulimin e kreditimit të saj, pas shpërthimit të krizës dhe recesionit të viteve 2008-2009”? Ekspertët e politikave monetare dhe bankierët qendrorë mendojnë se nuk kemi të bëjmë me një vendim që mund të kufizohet brenda SHBA-së, por për një vendim që pritet të ketë efekte ndërkombëtare, duke shkaktuar turbulenca në shumë vende të botës. Duket se FED-i nuk e ka marrë parasysh këtë fakt kur, në emër të përmirësimit të shëndetit ekonomik e financiar të SHBA-së, mori vendimin për rritjen e normës bazë të interesit dhe shpalli prirjen e rritëse për 3 vitet e ardhshme.

E parë në një këndvështrim më të gjerë edhe në raport me vendimet e fundit të bankave qendrore në Japoni, Europë, Angli, Rusi, Kinë, etj., vlerësohet se të gjithë po binden se epoka e “parasë së lirë” po merr fund, ku ekonomitë e reja rrezikohen nga destabilizimi, si pasojë e rrezikut të largimit të investimeve dhe investuesve drejt dollarit dhe SHBA-së. Një skenari të ngjashëm i tremben edhe një seri vendesh të varfra e në zhvillim, përfshirë këtu dhe Shqipërinë, që janë mjaft të varura nga IHD-të dhe financimet ndërkombëtare, të cilat me fillimin e 2016-ës rrezikojnë të

orientohen me shpejtësi drejt dollarit, duke shtrenjtuar ndjeshëm si kostot e ardhshme të investimeve, ashtu dhe kostot e borxhit.

Politika monetare amerikane e 10 viteve të fundit, me një normë bazë interesi thuhet zero, bëri që në emër të sigurimit të normave më të mëdha të fitimit, shumë fonde investimesh e kapitalesh të investoheshin në vende si: Turqia, Brazili, Afrika e Jugut, Meksika, Nigeria, Maroku, Egjipti, Gana, Indonezia, India, Rusia, Argjentina, Koreja e Jugut, Kili, Europa qendrore e lindore, ish-republikat e Bashkimit Sovjetik, etj. Me ndryshimin e kahut të politikës monetare amerikane, të gjithë këto vende rrezikojnë të cilësohen si jo tërheqëse dhe të përballen me një eksod masiv kapitalesh, duke vënë në rrezik rritjen ekonomike dhe zhvillimin ekonomik - social të tyre, sidomos politikën për reduktimin e varfërisë. Banka Botërore e ka dhënë së fundmi alarmin për këtë rrezik duke i “këshilluar këto vende që të shtrëngojnë rripin dhe të përgatiten që të përballen me turbulenca financiare e sociale”. Ekonomitë e shumë vendeve janë tashmë shumë të varura ndaj përqindjeve të interesit të huave në dollar dhe çmimeve të lëndëve të para, që fiksohen gjithashtu në dollarë. Nëse vërtetohet skenari i eksodit të kapitaleve nga këto vende, pasojat do ishin të rënda: shtrenjtimit dhe pakësimi i huadhënies, vështirësi në menaxhimin e bilancit të pagesave, shtrëngesa fiskale të

përhershme, klasifikime më të ulëta nga agjencitë e klasifikimit të besueshmërisë, etj.

Një efekt tjetër i pritshëm i vendimit të FED-it është rreziku që vjen si pasojë e forcimit të dollarit amerikan në tregjet financiare dhe tregtinë ndërkombëtare. Natyrshëm që forcimi i dollarit prek fuqinë konkurruese të eksporteve amerikane, por më shumë se kaq, ky forcim prek gjithë bizneset dhe korporatat, kudo në botë, të cilat kanë bërë kontrata disavjeçare në dollar, në momentin kur dollari ishte më i dobët, e për pasojë do jenë të detyruara të shlyejnë detyrimet e tyre duke blerë dollarë më të shtrenjtë. E njëjta gjë vlen dhe për vendet që kanë marrë borxhe në dollarë, të cilat duhet t'i shlyejnë me dollarë më të shtrenjtë, përveç faktit që forcimi i dollarit do të rëndojë edhe më shumë peshën e borxhit në ekuilibrat makroekonomikë të tyre. Ndikim pritet të ketë dhe te individët, apo bizneset që kanë marrë hua në dollarë, por që veprimtaritë dhe të ardhurat e tyre i kanë në monedhat vendase, ose në monedha të tjera ndërkombëtare. Për këtë kategori, shlyerja e kësteve të huas në dollarë do të thotë shtrenjtimit i menjëhershëm i huave të tyre. Në të kundërt, bizneset që kanë kontraktuar shitje dhe pagesa në dollarë për 3-4 vitet në vazhdim do të kenë përparësi nga forcimi i dollarit, ashtu si dhe sipërmarrjet europiane, që eksportojnë në SHBA, apo në zonat tregtare të dollarit.



Kredi Hipotekore



Interes fiks **3.9%** në Eur për vitin e parë
Nga **5%** interes për periudhën e mbetur
Shpenzime **0** pas vitit të parë



ALPHA BANK

Alpha Bank Albania fiton çmimin e Filantropisë 2015 në nivel kombëtar

Më 4 dhjetor, banka mori çmimin e filantropisë 2015 në nivel kombëtar, për ecurinë e spikatur në përqasjen e përgjegjesisë sociale të korporatës dhe veprimtaritë e zhvilluara në këtë kuadër. Z. Gent Sejko, Guvernator i Bankës së Shqipërisë i dorëzoi çmimin për kontribut në nivel kombëtar z. Periklis Drougkas, Drejtor Ekzekutiv i Alpha Bank Albania, me motivacionin: “Për mbështetjen e vazhdueshme në fushën e shëndetësisë, edukimit, mjedisit, artit dhe kulturës e veçanërisht për kontributin në nismat kundër kancerit të gjirit, sigurimin e aparaturës për diagnostikimin e problemeve të mundshme të foshnjave në maternitetin “Mbretëresha Geraldinë” dhe rikonstruksionin e çerddes “Zërat e Jetës” në Kamëz.



Së bashku festat janë më të bukura

Në këtë fundvit, Banka iu bashkua nismës së Bashkisë së Tiranës për të kthyer sheshin “Nënë Tereza” në një treg Krishtlindjesh, duke i dhënë kështu qytetit, një atmosferë festive gjatë gjithë muajit dhjetor. Konkretisht, Banka mbështeti ndërtimin e pistës së patinazhit, që ishte dhe një nga risitë e këtij organizimi.

Forumi i Sigurisë

Alpha Bank Albania mbështeti Forumin e parë të Sigurisë, me temë: “Një qasje e përgjithshme mbi sigurinë”. Forumi u fokusua në dy nivele sigurie: sigurinë fizike, të lidhur me objektet, mallrat, pronën dhe personat, dhe sigurinë e informacionit, lidhur me të dhënat e korporatave, rrjeteve, komunikimit dhe infrastrukturës informative.

Fondacioni Down Syndrome Albania

Banka mori pjesë në ballon presidenciale, organizuar nën kujdesin e Presidentit të Republikës, SH.T, Bujar Nishani dhe Zo-njës së Parë, Odeta Nishani. Të ardhurat nga kjo ballo shkuan në mbështetje të fëmijëve

me sindromën Down. Gjithashtu, Alpha Bank Albania uroi gjithë kolegët, klientët dhe bashkëpunëtorët e saj nëpërmjet një kartoline, të pikturuar nga piktorja Irma Nika.

Çerdhja “Zërat e Jetës”

Në 31 dhjetor, banka u shpërndau dhurata, fëmijëve të çerddes “Zërat e Jetës” në Kamëz, të cilën banka e ka adoptuar në muajin shtator duke iu bashkuar nismës: “Adopto një çerddhe”.



Supa e dashurisë

Stafi i Bankës kontriboi me paketa ushqimore, që u dorëzuan pranë kuzhinës së “Supa e dashurisë”, e cila funksionon që prej 10 vitesh nën kujdesin e Kishës Ortodhokse Autoqefale Shqiptare. Kjo qendër i shërben çdo ditë, më shumë se 150 njerëzve në nevojë.



Ambasada Shqiptare në Turqi

Dita e Pavarësisë festohet çdo vit nga Ambasada Shqiptare në Turqi. BKT mbështeti festimet që u mbajtën me këtë rast.



Konsullata e Përgjithshme në Stamboll

BKT mbështeti Konsullatën e Përgjithshme Shqiptare në Stamboll për organizimin e festimeve me rastin e Ditës së Pavarësisë, duke

promovuar artin dhe kulturën shqiptare jashtë kufijve të saj.

Ceremonia e Diplomimit FASTIP

BKT vazhdon të mbështesë programin FASTIP në bashkëpunim me Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës. Këtë vit u diplomua brezi i pestë i studentëve të FASTIP, të cilët u punësuan në BKT.



Shkolla 9-vjeçare Mustafa Qemal Atatürk BKT, në funksion të misionit të saj për të mbështetur arsimin, kontriboi financiarisht në rikonstruksionin e shkollës 9-vjeçare “Mustafa Qemal Atatürk”, me qëllim përmirësimin e kushteve mësimore.

Universiteti Ismail Qemali, Vlorë

BKT mbështeti universitetin, duke financuar veprimtari të ndryshme akademike dhe kulturore.

Banka më e mirë në Shqipëri për 2015 nga The Banker

Banka Kombëtare Tregtare u përzgjodh sërisht si “Banka më e mirë në Shqipëri për 2015 nga “The Banker”, një nga revistat më prestigjioze financiare, një publikim i Financial Times, i cili përzgjodh çdo vit bankat më të mira në botë. Ky është viti i tretë që BKT vlerësohet me tre nga çmimet më të mëdha (The Banker, Euro-money dhe EMEA Finance) në industrinë bankare.



Përgjegjshmëria Sociale



Gjatë tremujorit të katërt 2015, Banka Ndërkombëtare Tregtare ndërmori disa nisma:

- Në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar, zhvilloi seancën e dytë të dhurimit të gjakut për vitin 2015 në mjediset e bankës, përkatësisht në datë 20 nëntor 2015.



- Banka përzgodhi Fshatin SOS për sponsorizimin e kartolinave të festave të Fundvitit. Gjithashtu, punonjësit e Bankës kontribuan në mënyrë vullnetare për të mundësuar blerjen e një shporte me ushqime për një nga Familjet e Fshatit SOS për festat e fundvitit.



- Rrjeti Shqiptar i Përgjegjshmërisë Sociale (Albanian CSR Network), në bashkëpunim me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si dhe me UNDP Albania, organizoi për të dytin vit radhazi dhënien e çmimeve për shoqëritë më të mira në fushën e Përgjegjshmërisë Sociale. Juria zgjodhi si fituese për kategorinë e tretë Bankën Ndërkombëtare Tregtare, e cila u nderua me çmimin: “Iniciativa më e mirë”.



Ndihmoni ata që nuk janë si ju! - 17 tetor - Dita Botërore Kundër Varfërisë Ekstreme
Në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar, në kuadër të Ditës Botërore për Tejkalimin e Varfërisë Ekstreme, Banka organizoi mbledhjen e fondeve me qëllim sensibilizimin dhe kontributin konkret në ndihmë të 200 familjeve dhe njerëzve në nevojë me moton: “Ndihmoni ata që nuk janë si ju”.

Gjaku nuk mund të krijohet në laborator ai vetëm mund të dhurohet!

Për të pestin vit radhazi punonjësit e Intesa Sanpaolo Bank Albania morën pjesë në nismën e dhurimit vullnetar të gjakut në datat 25-26 nëntor 2015, në bashkëpunim me Shoqatën Shqiptare të Dhuruesve Vullnetarë të Gjaktit.

“Dhuro një libër! Dhuro dije! Dhuro dashuri!”

Në nëntor – dhjetor 2015, banka organizoi një nismë të brendshme bamirësie. Punonjësit dhuruan libra për dy institucionet: Shtëpia e Fëmijës “Zyber Hallulli” në Tiranë (rreth 70 tituj) dhe Strehëza për Gratë & Vajzat, në mbështetje të nismës STOP DHUNË! (rreth 30 tituj).



Dhuro me zemër, jepi mundësinë të festojnë edhe 4 personave me aftësi të kufizuar!

Me dëshirën për të dhuruar sadopak gëzim në periudhën e festave, punonjësit e bankës dhuruan ndihmë në para, përmes transferave të drejtpërdrejta në llogaritë të 4 personave me aftësi të kufizuar, sipas një listë emërore të marrë nga Shoqata e Pavarur për Kujdesin e Fëmijëve me Zhvillim të Vonshëm Mendor dhe Fizik në Tiranë.

Trekëndëshi i suksesit për të rinjtë sipërmarrës: Shoqëri Civile – Biznese – Arsimim
Një nga projektet e Junior Achievement u mbështet edhe nga banka, e cila përmes angazhimit vullnetar të stafit të saj po kujdeset në 3 qytete: Tiranë, Durrës dhe El-

basan, për nxënësit e shkollave të mesme të përgjithshme të klasave 11 dhe 12, përgjatë zhvillimit të lëndëve: “Etika në Biznes”, “Aftësi për Sukses” dhe “Si të bëhesh Sipërmarrës Shoqëritë e Nxënësve”.



Dhurim gjaku për fëmijët talasemikë

Si çdo vit, banka organizoi në mjediset e zyrave të saj qendrore një veprimtari vullnetare për dhurim gjaku, e mundësuar me mbështetjen e njësisë levizëse të Kryqit të Kuq Shqiptar. Stafit të Bankës ProCredit mori pjesë masivisht në një dhurim të tillë, për t'u ardhur në ndihmë fëmijëve talasemikë dhe të gjithë njerëzve që janë në nevojë.



Raiffeisen Bank dhe Bashkia e Tiranës përuan projektin e rikonstruksionit të rrugës "Dritan Hoxha". Pjesë e këtij projekti ishin edhe korsitë e biçikletave, që u financuan nga Raiffeisen Bank. Në ceremoninë e organizuar me këtë rast, Z. Christian Canacaris, Drejtor i Përgjithshëm i Raiffeisen Bank dhe Z. Erjon Veliaj, Kryetar i Bashkisë së Tiranës, zgjodhën të pedalonin me biçikleta përgjatë korsive të reja, së bashku me një grup të rinjsh.



Përgjegjshmëria Sociale



Festivali Ndërkombëtar Operistik "Marie Kraja", 30 - 31 tetor 2015

Banka mbështeti Festivalin Ndërkombëtar Operistik "Marie Kraja", i cili u zhvillua në 30 - 31 tetor 2015, për të 15-in vit rradhazi. Festivali ishte i hapur për këngëtarë nga e gjithë bota. Këtë vit u përzgjidhën 15 pjesëmarrës nga rreth 170 aplikime, të cilët u intervistuan nga juri të ndryshme në Milano, Vjenë, Bruksel dhe Tiranë.



Societe Generale Albania mbështet sipërmarrësit e rinj

Banka bashkëpunoi me Start Up Tirana, duke organizuar "Startup Weekend Tirana 5.0", nga data 20 - 22 nëntor 2015. Ky event u organizua në mjediset e Parkut të Biznesit të Tiranës. Ide të reja erdhën në jetë nga sipërmarrës të rinj. Societe Generale Albania mori pjesë jo vetëm si sponsor në këtë event, por pati gjithashtu një anëtar jurie, Z. Ardian Hasa, Drejtor i Divizionit Operacional.



Vijon tradita e dhurimit të gjakut

Tirana Bank, në bashkëpunim me Qendrën e Transfuzionit të Gjakut, organizoi në 28 tetor, për të shtatin vit rradhazi, dhurimin vullnetar të gjakut.

Në mbështetje të YWCA në ndërgjegjësimin për kancerin e gjirit

Edhe këtë vit, Banka iu bashkua kësaj nisme duke mbështetur fushatat në televizion, dhe duke shtypur dhe shpërndarë afishe, për të nxi-



tur ndërgjegjësimin dhe ekzaminimet.

Muzeu i shkollës së Mesme "Themistokli Gërmenji"

Banka mbështeti krijimin e muzeut në mjediset e shkollës së Mesme "Themistokli Gërmenji" në Korçë, me rastin e 50 vjetorit të kësaj shkolle, i cili shërben si urë lidhëse në bashkimin e brezave, studentë e mësues të këtij institucioni.



Festa e Verërave, Pogradec

Nën një atmosferë të gëzueshme fundviti, më 18 dhe 19 dhjetor u zhvillua në Pogradec, "Festa e Verërave 2015" ku prodhues lokal të verërave paraqitën prodhimet e tyre. Nuk ka munguar edhe këtë vit ndihma e Tirana Bank, me synim paraqitjen e traditës dhe mbështetjen e sipërmarrësve vendas.

Koncerti i Fundvitit "Ndërmendje", 2015

Vijoi mbështetja e koncertit të muzikës klasike, "Ndërmendje", i cili pasqyron qartë shpirtin artistik të qytetit të Shkodrës, duke sjellë çdo fundvit pjesë të mrekullueshme klasike nga autorët më të njohur të huaj e vendas.

Tirana Bank mbështet fëmijët e Zall Herrit në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës

Edhe këtë vit, shumica e caktuar për blerjen dhe shpërndarjen e dhuratave për klientët dhe partnerët e Tirana Bank, u dhurua në mbështetje të shtresave në nevojë. Dhuratat e këtij fundviti shkoi për 105 familje në nevojë në Zall Herr, në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës.



Union Bank ka mbështetur organizimin e Festës së Fundvitit në bashkëpunim me Qendrën Publike të Zhvillimit Rezidencial Berat.

Në sajë të kontributit të Union Bank, në dt 28 dhjetor 2015 në mjediset e Qendrës Publike u organizua Festa e Fundvitit për personat me aftësi të kufizuar.

Drejtoresha e degës Berat, Zj. Leonora Shosha, në emër të Union Bank, i dorëzoi simbolikisht çekun drejtoreshës së Qendrës.



Në mbështetje të Policisë së Shtetit

Veneto Banka vazhdon mbështetjen e saj për strukturat e Policisë së Shtetit, duke qenë kështu një partner mjaft aktiv me Ministrinë e Brendshme. Pas ndërhyrjes në investimin e saj financiar në Pikat e Kalimit Kufitar kudo nëpër Shqipëri, këtë herë ishte Akademia e Rendit dhe Shkolla Bazë e Policisë, ku Veneto Banka rehabilitoi hyrjen kryesore të kësaj shkolle, ku priten të studiojnë rreth 300 studentë të rinj për trupën policore të shtetit.



Në mbështetje të Arsimit Profesional

Për të dytin vit rradhazi Banka mbështet studentët e Kulinarisë, të cilët ndjekin studimet e tyre pranë Institutit "Neranxi". Përveç mbështetjes financiare ofron edhe financime të ndryshme me kushte lehtësuese, për kryerjen e studimeve pranë këtyre shkollave, si dhe financon ngritjen e biznesve start-up nga ana e studentëve, pas përfundimit të instituteve profesionale.

Veneto Banka mbështet Dentistët

U zhvillua në Tiranë Kongresi i Dentistëve të Shqipërisë dhe Rajonit, ku morën pjesë mijëra dentistë nga Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia, Kosova, etj. Pjesë e këtij



Kongresi ishte dhe Panairi Dentar, ku Veneto Banka në vijim të bashkëpunimit si Partner Zyrtar i Dental Leader Corsi, mbështeti financiarisht prezantimin e këtij të fundit në këtë Panair, duke qenë kështu bashkëudhëtare e zhvillimit të arsimit dhe trainimit profesional në Odontotripi.

LLOGARI NË RMB

Gold Member of



SHQIPËRI



KINË



NJË LLOGARI NË VALUTË KINEZE!

Administro më mirë
kapitalin e biznesit tënd

开立中人民币账户。改善你的企业资金管理。
与中国做生意变得比以往更容易！

**BIZNESI ME
KINËN BËHET
MË I THJESHTË
SE KURRË!**

- Eliminoni risqet dhe tarifat e një këmbimi valutor të huaj.
- Eliminoni ndërmjetësit dhe kryeni veprime të thjeshta dhe të shpejta.
- Hap një llogari në RMB dhe transferoni paratë tuaja në Kinë thjesht, shpejt dhe pa burokraci.

WWW.ICB.AL

 04 22 56 254



INTERNATIONAL COMMERCIAL BANK
rëndësi kanë vlerat





nga Zj. Anila HOXHA, CISSP, CISA

Drejtoare e Qendrës Operative të Sigurisë & IT

RAIFFEISEN BANK – SHQIPËRI

Qendra operative e sigurisë, e njohur dhe si qendra e monitorimit (dhe kontrollit), nuk është një koncept apo prioritet, megjithatë vitet e fundit vihet re një vëmendje më e shtuar ndaj këtij koncepti. Në bizneset ku siguria është në funksionin mirë-stabilizuar, e ku të gjithë funksionet dhe elementët e saj (siguria fizike dhe e informacionit, menaxhimi i incidenteve e vazhdimësia e biznesit) janë të mirë-integruara me njëra – tjetrën, ky përbën një hap të natyreshëm. Megjithatë, në tregun vendas ky koncept mbetet i paeksploruar plotësisht. Në vijim do të shihet shkurtimisht nevoja për një qendër kontrolli e monitorimi, sfidat për ndërtimin e saj si dhe përparësitë dhe përfitimet që ajo sjell.

Sfidat me të cilat përballemi sot janë realisht të shumta, të tilla si:

- **Operohet në mënyrë të fragmentuar**
- shpeshherë siguria shihet dhe funksionon e ndarë mes sigurisë fizike dhe të informacionit, madje në disa shoqëri

Qendrat e Operacioneve të Sigurisë

Sfidat dhe përparësitë që ofrojnë



Duke pasur parasysh sfidat me të cilat përballemi sot, si ato organizative ashtu edhe ato mjedisore, e vetmja mënyrë për të garantuar efikasitetin e sigurisë është përdorimi i qendrës së kontrollit dhe monitorimit, për të kaluar drejt një sigurie inteligjente.



këto dy funksione operojnë në struktura organizative të ndryshme, duke pasur pak ose thajse aspak sinergji mes tyre.

- **Punohet me shumë zgjidhje të pavarura fundore**, që operojnë në mënyrë individuale, që nga sistemet antivirus, firewall, sisteme detektimi apo parandalimi IPS/IDS, sistemet e aksesit, sistemet e alarmit që operojnë individualisht në çdo degë, apo vendndodhje (për aksesin fizik, detektim zjarri, detektim thyerje/hyrje të pa-autorizuar), sistemet e monitorimit CCTV, etj.

Bizneset në përgjithësi, e bankat në veçanti, investojnë në disa sisteme mbrojtjeje teknike dhe jo-teknike, kryesisht të jetësuar në një mënyrë që të krijojnë disa barriera të ndryshme mbrojtjeje (ndonjëherë të vendosura njëra mbi tjetrën – *defense in depth*). Sigurisht, kjo mënyrë ndihmon dhe garanton sigurinë maksimale, por për sa kohë këto barriera operojnë në mënyrë të pavarur dhe individuale, mungon një pamje e plotë mbi statusin e përgjithshëm dhe efektivitetin e të gjitha barrierave, të marra së bashku. Pra, mungon një panoramë e harmonizuar e gjithë sistemit të kontroleve të sigurisë (funksionimin apo mosfunksionimin e tyre), e kjo e bën të vështirë të arrijmë t'i përgjigemi dhe pyetjeve të thjeshta, si p.sh.: cila është rrjedha e veprimeve dhe kur ka ndodhur secila, që nga momenti

kur dikush hyn fizikisht në një godinë, e deri kur akseson sistemin më kritik (që përbën dhe *thesarin* e biznesit). E rëndësishme për t'u konsideruar është dhe mjedisi rrethues i rreziqeve teknike dhe jo-teknike. Prioriteti i sulmeve sa vjen e rritet, si në numër ashtu dhe në sofistikim, e po kështu dhe kërkesat e rregullatorit, për standarde të larta sigurie. Në këtë kuadër, qendra e kontrollit dhe monitorimit ofron një pamje të plotë harmonike të të gjithë barrierave mbrojtëse në kohë reale, duke bashkuar në këtë mënyrë të gjithë copëzat e mozaikut e duke na dhënë atë panoramë të plotë të sigurisë së një shoqërie. Ajo shërben si bërthama e gjithë funksioneve të sigurisë dhe ndërtohet për të kontrolluar e monitoruar në mënyrë qendrore të



Filozofia e qendrës së kontrollit e monitorimit është tërësisht e ndërtuar mbi procese të qarta. Asgjë më lart nuk mund të funksionojë pa pasur procese të mirë-përcaktuara për analizën, monitorimin e vazhdueshëm dhe reagimin e menjëhershëm, në rast ngjarje.



gjithë sistemet e barrierat mbrojtëse, duke na dhënë në këtë mënyrë informacion në kohë reale, për çdo situatë.

Sfidat e ndërtimit të një qendre monitorimi dhe kontrollit

Ndërtimi i një qendre të tillë sigurisht ka sfidat e saj jo të vogla. Së pari, është shumë e rëndësishme që shtrirja dhe kërkesat e saj të jenë të qarta që në fillim. Pra, duhet të përcaktohet qartë mbulimi që do ketë qendra – të gjithë sistemet teknike (infrastruktura e rrjetit, aplikacionet veçanërisht ato me kritiket, databazat, etj., sistemet jo-teknike si sistemet e sigurisë fizike, sistemet e aksesit, sistemet e alarmit, sistemet anti-zjarr, sistemet e energjisë elektrike (gjeneratorë, UPS, etj), sistemet e kondicionimit etj. Pasi janë përcaktuar qartë, duhet të merret edhe mbështetja nga strukturat drejtuese, e kjo jo vetëm për shkak të nevojës për investim dhe buxhetin e konsiderueshëm që nevojitet, por edhe për faktin se ngritja dhe operimi i një qendre të tillë sjell ndryshime në kulturën organizative. Sigurisht, ndërtimi i saj nuk mund të ndodhë menjëherë me një *big bang*, por kërkon një plan të ndarë në faza të ndryshme, me kritere dhe objektiva të mirë-përcaktuara në secilën fazë. Tri janë shtyllat bazë, mbi të cilat mbështetet qendra e monitorimit dhe kontrollit: (1) Stafit, (2) Teknologjia/Sistemi i monitorimit, (3) Proceset.

Stafit

Stafit që operon qendrën është një pjesë shumë e rëndësishme dhe ndër sfidat më të mëdha. Ata duhet të kenë një kombinim të mirë mes cilësive të përparuar analitike dhe aftësive shumë të mira komunikuese. Përpos tyre, disa nga aftësitë e cilësive të tjera të domosdoshme përfshijnë: (i) kureshtarë deri në ekstrem, (ii) të aftë të analizojnë deri në detajet më të vogla një situatë, por pa e humbur pamjen e përgjithshme, (iii) të komunikojë lirshëm me grupe të ndryshme që kanë kërkesa të ndryshme, dhe (iv) nuk e humbasin toruan dhe reagojnë mirë në situata nën tryzni. Këto aftësi e cilësi duhen kombinuar me trajnime të vazhdueshme.

Teknologjia

Teknologjia është pjesa kyç e qendrës. Praktikisht nuk mund të operohet pa një sistem të avancuar monitorimi, i aftë të mbledhë dhe lidhë automatikisht sasi të mëdha të dhënash nga burime të shumta sistemesh (si: *firewall*-e, IPS, pajisje rrjeti, aplikacione, databaza, sistemi i

aksesit, sistemi i alarmit, etj.) Në themel të qendrës së monitorimit e kontrollit qëndrojnë sistemet *SIEM* – sisteme për mbledhjen, përpunimin, lidhjen dhe analizimin automatik të të dhënave nga gjithë burimet e mundshme. Sisteme të tilla, nëpërmjet mbledhjes së të dhënave në mënyrë të vazhdueshme nga gjithë sistemet e përfshira (përfshirë edhe ato të sigurisë fizike), arrijnë të:

- Krijojnë një prirje të gjendjes normale të mjedisit të brendshëm infrastrukturor,
- Ndhimjnë në detektimin e shpejtë të veprimtarive, apo situatave anormale, ose të dyshimta,
- Ofrojnë të dhëna të detajuara, për të analizuar nga afër një rast specifik,
- Integrojnë dhe përpunojnë të dhëna inteligjence nga rreziqet e mjedisit të jashtëm, dhe i përdorin për të pikasur modele të ngjashme sjelljeje anormale në mjedisin e brendshëm.



Qendra e kontrollit dhe monitorimit ofron një pamje të plotë harmonike të të gjithë barrierave mbrojtëse në kohë reale, duke bashkuar në këtë mënyrë të gjithë copëzat e mozaikut e duke na dhënë atë panoramë të plotë të sigurisë së një shoqërie.



Proceset

Filozofia e qendrës së kontrollit e monitorimit është tërësisht e ndërtuar mbi proceset të qarta. Asgjë më lart nuk mund të funksionojë pa pasur procese të mirë-përcaktuara për analizën, monitorimin e vazhdueshëm dhe reagimin e menjëhershëm, në rast ngjarje. Në rast ngjarje, duhet të jetë e përcaktuar qartë në procedurat operative të qendrës cili është zinxhiri i veprimeve, përfshirë dhe procedurat e përshkallëzimit. Ky proces reagimi duhet integruar plotësisht me proceset e menaxhimit të incidenteve të shoqërisë. Për shembull, gjatë monitorimeve vërehet veprimtari gjatë fundjavës, apo dite pushimi, në një degë të bankës, – duhet të ekzistojë një paketë mirë-përcaktuar hapash për stafin monitorues, që të kuptojë verifikimet që duhen ndërmarrë (kontrolle e verifikime të log-ëve në sisteme, i sistemit të aksesit në degë, i sistemit të kasafortës, lista e stafit

të autorizuar për të punuar edhe jashtë orarit zyrtar, etj.), personat që duhen kontaktuar për verifikime të mëtejshme, si edhe kush duhet njoftuar e në çfarë kohe. A përbën kjo një incident, nëse po, a kërkon thirrje të grupit të menaxhimit të incidenteve, a kërkon përshkallëzim të komiteti i krizave, etj. Të gjithë këto hapa duhet të jenë të shkruar e të përcaktuar, si pjesë e proceseve të qendrës.

Përparësitë dhe përfitimet e qendrës së kontrollit dhe operimit

Kjo qendër mundëson dhe jep një pamje të të gjithë eko-sistemit të sigurisë, duke ofruar në kohë reale monitorim të të gjithë barrierave mbrojtëse. Konkretisht ajo:

- Ndhimmon në reagim të menjëhershëm.

Qasja në kohë reale të informacioni i përpunuar, mundëson reagim të shpejtë, në rast sulmi të jashtëm (qofte teknik, nëpërmjet *malware*-ve, apo fizik, si: hyrje me forcë apo tentativë grabitjeje). Zbulimi i shpejtë i vjedhjeve/abuzimeve/shkeljeve të brendshme, nëpërmjet monitorimit të vazhdueshëm të prirjeve, ul ndikimin e përgjithshëm negativ të ngjarjes.

- **Mundëson siguri inteligjente.** Duke paraqitur një vështrim të plotë dhe të qartë të gjendjes aktuale të sigurisë, ajo bën të mundur edhe parashikimin efektiv të burimeve të nevojshme dhe investimeve për të ardhmen.

- **Ofron tregues të matshëm sigurie.** Hartimi i treguesve të tillë është një sfidë madhore sot, megjithatë informacioni i agreguar ë ofron qendra mundëson pikërisht hartimin dhe ofrimin e këtyre treguesve të dobishëm, si p.sh.: cila është përqindja e degëve që qëndrojnë hapur përtej mesatares në rang banke. Ky tregues kërkon analizën e prirjes së mbylljes së degëve në një hapësirë kohore prej disa javësh/muajsh, nëpërmjet lidhjes së informacionit logjik në aplikacione me atë të sistemeve të alarmit.

Përfundim

Qendra e kontrollit dhe monitorimit është një domosdoshmëri absolute për sigurinë. Duke pasur parasysh sfidat me të cilat përballemi sot, si ato organizative ashtu edhe ato mjedisore, e vetmja mënyrë për të garantuar efikasitetin e sigurisë është përdorimi i qendrës së kontrollit dhe monitorim, për të kaluar drejt një sigurie inteligjente. Vetëm kjo na garanton fleksibilitetin dhe aftësinë për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive e në kohë rreziqeve të sotme dhe atyre në vijim.



nga Zj. Elsa PECA

Drejtoresh e Departamentit të Riskut
BANKA NDËRKOMBËTARE TREGTARE (ICB)

Ristrukturimi i huave përkufizohet si çdo modifikim që i bëhet planit fillestar të pagesës që ka nënshkruar klienti me bankën, në momentin e marrjes së një huaje, si rrjedhojë e rritjes së mundësisë aktuale, apo të ardhshme, që kjo hua të shfaqë probleme në pagesën në kohë të detyrimit. Ristrukturimi i huas është një proces që i jep mundësi klientëve të bankës (individë apo biznese) që kanë vështirësi financiare, për të zvogëluar pagesën aktuale të kështit nëpërmjet zgjatjes së afatit të mbetur të huas. Njëkohësisht, gjatë ristrukturimit banka mund të përmirësojë pozitën e mëparshme të kolateralit, si dhe të rishikojë normën e interesit dhe kushtet e tjera të huas. Ristrukturimi i huas mund të iniciohet nga vetë klienti, ose nga banka. Me qëllim që të bëhet i mundur ristrukturimi, duhet të plotësohen njëkohësisht dy kushte:

1. Klienti duhet të gjenerojë ende

Ristrukturimi i huas

Testimi i klientit përpara vendim marrjes për ristrukturim



Ristrukturimi i huas mund të konsiderohet si një mekanizëm i vlefshëm për uljen e huave me probleme, nëse ai përdoret me efikasitet, duke e vënë theksin në përdorimin e metodës “së provës”, përpara finalizimit të procesit.



të ardhura, pra të ketë aktiv biznesin e tij, nëse flasim për një hua biznesi, apo të ketë të ardhura nga pagat ose burime të tjera të ardhurash, nëse flasim për një hua individuale. Konkretisht, biznesi apo individ duhet të gjenerojë të ardhura, të cilat qartazi janë të zvogëluara në krahasim me të ardhurat që kishte në momentin e lëvrimin të huas, për sa kohë ndodhet në vështirësi financiare.

2. Klienti duhet të ketë treguar vullnet për të paguar, pra është i gatshëm të paguajë huan dhe se vonesat në pagesa kanë ardhur nga pamundësia financiare dhe jo nga mosdëshira për të paguar. Ky kusht është shumë i rëndësishëm të evidentohet, pasi në të kundërt ristrukturimi do të rezultojë jo efikas dhe banka do të jetë në të njëjtën situatë me këtë klient, pas ristrukturimit.

Banka duhet të jetë e kujdesshme me vendim marrjen për ristrukturimin, pasi ristrukturimi i huas shoqërohet me kosto shtesë për bankën. Bankës i duhet të provizionojë huan e ristrukturuar në masën 10 për qind të shumës së ristrukturimit dhe të mbajë këtë nivel provizionesh edhe për të paktën 6 muaj, pas ristrukturimit, nëse klienti paguan 6 këste të plota në mënyrë të

rregullt. Ndërkohë, si kosto shtesë për klientin, përveç atyre administrative për marrëveshjen e re që do të lidhë me bankën, e që përfshin noterizimin e kontratave dhe bllokimet e kolateraleve në hipotekë (nëse aplikohen të tilla), përfshihen edhe kostot e mundshme të përmbarrimit, nëse procedurat ligjore



Një element shumë i rëndësishëm është dhe monitorimi i huave pas ristrukturimit, të cilat duhen ndjekur nga afër prej Departamentit të Huave me Probleme, apo nga ndonjë departament tjetër i posaçëm i ngritur për këtë qëllim në bankë, ecuria e huave të ristrukturuara, si dhe veprimet e mëtejshme që duhen ndërmarrë nga banka, në rast të mos-pagesës nga ana e klientit, të cilët diskutohen në komitetet përkatëse që ka ngritur banka në strukturat e saj, të paktën një herë në tre muaj.



DHUROJI VETES

NJE VLERE NE KOHE



INTESA SANPAOLO BANK

PER ÇDO DEPOZITE TE RE DERI NE 5.000.000 LEKE
PERFITO INTERESIN 3%, ME I LARTI NE TREG PER PERIUDHEN 18 MUAJ

NJE BOTE MUNDESISH REALE

www.intesasanpaolobank.al

CALL CENTER
08006000 (Falas nga Albtelecom & Eagle)
+355 4 2276000
+355 692080903

BANK OF INTESA SAN PAOLO GROUP
INTESA  SANPAOLO

do të rifillojnë, në rast se klienti nuk i përmbahet marrëveshjes së re të ristrukturimit.

Të gjitha këto kosto i duhen bërë të ditura klientit, përpara se ai të marrë vendimin për ristrukturimin. Procesi i ristrukturimit duhet parë si një zgjidhje afatgjatë dhe jo afatshkurtër për bankën, në mënyrë që banka të mos gjendet në të njëjtën situatë pas pak muajsh.

Një metodë shumë efektive është periudha 3 mujore “e provës” për klientët përpara ristrukturimit, me kështu të përafërt me kështin që do të ketë klienti pas ristrukturimit¹. Në këtë kuadër, bëhet një marrëveshje me shkrim me klientin, nëpërmjet një plani manual pagese, ku përcaktohet data e pagesës dhe kështi, për tre muajt e ardhshëm. Vetëm në rastet kur klienti paguan në mënyrë të rregullt të tre muajt në vijim dhe nëse analiza financiare që i bëhet atij e justifikon kështin e ri, i hapet rruga formalizimit të procesit të ristrukturimit dhe bëhet i mundur ristrukturimi në sistem, duke përgatitur kontrata të reja për marrëdhënien e re midis bankës dhe klientit, sipas kushteve dhe afateve të reja të huas. Në disa raste, përveç arsyeve të mësipërme, ristrukturimi mund të shihet edhe si një mënyrë për të forcuar pozitën e kolateralit, duke marrë një kolateral më të mirë se ai i mëparshmi, apo një kolateral të dytë, në rastet kur shihet që kolaterali ekzistues është jo i mirë, apo në rast se aktualisht ai nuk mbulon vlerën e huas, për shkak të zhvlerësimit që ka pësuar prona.

Siç u shpjegua dhe më lart, banka do të vazhdojë ta klasifikojë klientin në të njëjtën klasë që ka pasur përpara ristrukturimit, të paktën për një

periudhë gjashtëmujore, si dhe mund të bëjë riklasifikimin në një kategori më të lartë, vetëm pasi klienti të ketë paguar rregullisht dhe situata financiare e tij të jetë përmirësuar. Një element shumë i rëndësishëm është dhe monitorimi i huave pas ristrukturimit, të cilat duhen ndjekur nga afër prej Departamentit të Huave me Probleme, apo nga ndonjë departament tjetër i posaçëm i ngritur për këtë qëllim në bankë, ecuria e huave të ristrukturuara, si dhe veprimet e mëtejshme që duhen ndërmarrë nga banka, në rast të mos-pagesës nga ana e klientit, të cilët diskutohen në komitetet përkatëse që ka ngritur banka në strukturat e saj, të paktën një herë në tre muajt.

Banka Ndërkombëtare Tregtare ka ristrukturuar rreth 41 hua, të akorduara kryesisht gjatë viteve 2013-2015, e ndër këto hua rreth 30 klientë kanë treguar një ecuri shumë të mirë pas ristrukturimit, ndërkohë që vetëm 11 prej tyre kanë vazhduar të paguajnë me vonesa pas ristrukturimit; pra vetëm në 11 raste ristrukturimi nuk ka rezultuar efikas. Vlen të theksohet që huat e shumicës së këtyre klientëve kanë qenë të klasifikuara si “hua të humbura” përpara ristrukturimit, pra kanë qenë hua me më shumë se 365 ditë – vonesë, e për të cilat procedura ligjore kishte filluar, por nuk kishte rezultuar efektive. Pjesa dërrmuese e tyre i përkasnin shumave të huave që variojnë nga 30,000 - 50,000 euro, e që kanë marrë hua në monedhë të huaj, kryesisht në euro. Në momentin e ristrukturimit bëhet kthimi i huas në monedhën vendase, duke marrë në konsideratë edhe monedhën në të cilën ishin të ardhurat e klientit, për

të shmangur dhe zvogëluar rrezikun e kursit të këmbimit. Gjithashtu, duhet të theksohet që, afati fillestar i maturimit ka qenë kryesisht deri në 5 vjet, ndërkohë që afati pas ristrukturimit zgjatet, duke shkuar deri në 10 vjet, për t'i dhënë mundësi klientit të paguajë një kësht më të ulët, në varësi të situatës aktuale financiare të tij. Gjithashtu, bëhet edhe një rishikim i normës së interesit, duke marrë në konsideratë normat aktuale të tregut, gjë që ndikon pozitivisht në uljen e kështit për klientin. Gjithashtu, një pjesë e mirë e klientëve të ristrukturuar, në kohën e marrjes së huas, i përkisnin sektorit të ndërtimit dhe gjatë analizës së tanishme kishin ndërruar veprimtari, duke marrë në konsideratë faktin që sektori i ndërtimit ka paraqitur probleme likuiditeti gjatë vitit të fundit. Për më tepër, një pjesë tjetër e klientëve të ristrukturuar, në kohën e marrjes së huas, kishin të ardhura nga biznesi, por kishin kaluar në klientë me të ardhura nga paga, në momentin e ristrukturimit.

Për sa më lart, në Bankën Ndërkombëtare Tregtare më shumë se 70 për qind e huave të ristrukturuara kanë një ecuri pozitive pas ristrukturimit, ndërkohë që në sistemin bankar ky raport është vetëm 9 për qind. Në të njëjtën kohë, në sajë të mekanizmit të ristrukturimit është bërë e mundur dhe ulja e përqindjes së huave me probleme, për më shumë se 5 për qind.

Përmbledhtazi, ristrukturimi i huas mund të konsiderohet si një mekanizëm i vlefshëm për uljen e huave me probleme, nëse ai përdoret me efikasitet, duke e vënë theksin në përdorimin e metodës “së provës”, përpara finalizimit të procesit.



¹ Kjo është një metodë që ndiqet aktualisht nga Banka Ndërkombëtare Tregtare, ICB.

AAB AKTIVITETE

AAB organizon Forumin e katërt Kombëtar për Sigurinë Bankare

AAB, me mbështetjen e Komiteteve të saj për Sigurinë e Informacionit dhe Sigurinë Bankare, organizoi më 26 nëntor 2015, forumin kombëtar me temë: “Banka të sigurta, klientë të mbrojtur”. Forumi zhvilloi punimet e tij për të katërtin vit radhazi, në mjediset e Tirana International Hotel, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të bankave tregtare në Shqipëri e Kosovë, Bankës së Shqipërisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së

Shtetit, Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT), Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik (AKCE) dhe përfaqësues të shoqërive që ofrojnë shërbime dhe produkte në fushën e sigurisë së informacionit dhe atë fizike në sektorin bankar (Deloitte, PWC, INFIGO, Coin Systems).

Edhe këtë vit, Forumi shërbeu si një platformë për të shkëmbyer ide dhe eksperiencë, si dhe zhvillimet e dinamikat më të fundit, në nivel kombëtar e ndërkombëtar, të sigurisë fizike dhe asaj të informacionit në industrinë bankare.

Në përfundim, të gjitha grupet e interesit pjesëmarrëse në forum, theksuan edhe njëherë nevojën për bashkëpunim të të gjitha palëve me fokus mbrojtjen e klientëve.



Darka e Vitit të Ri

AAB organizoi në 16 Dhjetor 2015, darkën e përvitshme të fundvitit, në të cilën morën pjesë Drejtorët e Përgjithshëm dhe përfaqësues të tjerë të bankave anëtare të Shoqatës, dhe të ftuar të tjerë specialë si: Guvernatori, Zëvendës Guvernatorja e Parë, Drejtori i Departamentit të Mbikëqyrjes,

dhe Drejtori i Kabinetit të Guvernatorit nga Banka e Shqipërisë, Drejtori i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, dhe Kryeredaktori dhe anëtarët e bordit editorial të revistës “Bankieri”.

Kryetari i AAB-së, Z. Christian Canacaris, dhe Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Z. Gent Sejko përshëndetën të ftuarit në fjalimet e tyre të rastit.



Trajnimet e organizuara në bashkëpunim me ATTF Luksemburg

Operacionet e Zyrave Mbështetëse dhe Administrative, 21 – 23 tetor: Trajnimi ishte i pari bashkëpunim në Shqipëri midis AAB me ATTF Luksemburg. U drejtua nga Z. Paul Kleinbart, ekspert i lartë i ATTF-së, dhe u ndoq nga 17 përfaqësues të bankave.

Bazel II dhe përtej tij, 2 – 4 nëntor: Trajnimi u drejtua nga Z. Stefano Bragoli, nga Fondi European Investimeve, ATTF dhe ekspert i lartë i ATTF-së, si dhe u ndoq nga 19 përfaqësues të bankave në Shqipëri.

Menaxhimi Burimeve Njerëzore, 09 – 11 dhjetor: Drejtuar nga Z. Gilles Osona de Mendez, me pjesëmarrjen e 17 përfaqësuesve të bankave anëtare. Trajnimi u financua nga Ministria e Financave të Luksemburgut.

Trajnimet e organizuara me Qendrat Lincoln në Shqipëri

Komunikimet në Biznes: Arti i diskutimit, 05 – 06 nëntor: Trajnimi synoi njohjen e pjesëmarrësve me aftësitë dhe mjeshtritë për një komunikim më efektiv. U drejtua nga Z. Josh Miekley dhe u ndoq nga 8 përfaqësues të bankave anëtare.

Negociatorët e Mëdhenj: Arritja e rezultateve reciprokisht të kënaqshme nëpërmjet negociatave të favorshme, 12 – 13 nëntor: Programi u përqendrua në konceptet gjerësisht të pranuar themelore të negociatave. Trajnimi u drejtua nga Z. David Turner dhe u ndoq nga 9 përfaqësues të bankave anëtare.

Partnerë të tjerë

Zbulimi dhe parandalimi i mashtrimeve, 1 – 2 tetor: Trajnimi i organizuar nga AAB, në bashkëpunim me AIIA kishte si qëllim qasjen praktike në mjedisin lokal, përmes sesioneve ndërvepruese dhe ushtrimeve në grup. Trajnimi u ndoq nga 20 përfaqësues të bankave.

Parandalimi i mashtrimeve, 13 – 15 tetor: Për herë të parë në Tiranë u organizua një trajnim nga Visa Business School, i cili u ndoq nga 24 përfaqësues të bankave në Shqipëri dhe Kosovë. Trajnimi u përqendrua në fushat kryesore funksionale, duke përfshirë operacionet, menaxhimin e rrezikut të mashtrimit, monitorimin e kartëmbajtësve, të tregtarëve dhe kontrollet e humbjeve.

Lidershipi strategjik dhe qeverisja efektive, 23 – 24 nëntor: Trajnimi u organizua në bashkëpunim me WIFI Albania dhe u ndoq nga 13 menaxherë të lartë të 5 bankave anëtare.

Përdorimi i Pikëvlerësimit gjatë menaxhimit të rrezikut, 24 – 25 nëntor: Trajnimi u organizua në bashkëpunim me SBPS Technologies Company dhe u drejtua nga Z. Ajhan Akay, konsulent për menaxhimi e rreziqeve, me pjesëmarrjen e 9 përfaqësuesve të bankave në Shqipëri dhe Kosovë.



